

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5741  
E martë, 2 prill 2019  
çmimi 0.40 €

**Apostolova: Taksa 100 për qind, në kundërshtim me parimet e MSA-së**

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE



**ERDOGANI HUMBET QYTETET KRYESORE NË TURQI** F. 2

**GJYKATA THEMELORE REFUZON KËRKESËN PËR PEZULLIMIN E PENSIONEVE PËR VETERANËT** F. 7

**NË 20-VJETORIN E MASAKRËS SË LYBENIQIT KËRKOHEH DREJTËSI** F. 5

## EKONOMI

**MTI-ja FINANCON ZONËN EKONOMIKE NË LIPJAN ME 500 MIJË EURO** F. 8

**'NORWEGIAN AIR' LANSON LINJËN DIREKTE STOKHOLM - PRISHTINË - STOKHOLM** F. 9

## KULTURË

**KOMPOZITORËT NAIM GJOSHI DHE XHEVDET GASHI DEKOROHEN ME ÇMIMIN 'MJESHTËR I MERITUAR'** F. 11

## SPORT

**REXHA: DO TA RUAJMË EPËRSINË NDAJ PRISHTINËS DHE LLAPIT** F. 15

**GJILANI - DRITA ZHVILLOHET NË PRISHTINË, KUNDËRSHTOJNË 'PLISAT'** F. 16



SHKRUAN: DR. BAJRAM KOSUMI | FAQE 7

## Katër shtetet e vogla të Evropës Juglindore mund të bëjnë një bashkësi të fuqishme

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, RAMUSH HARADINAJ, KA PRITUR NË TAKIM DEPUTETËT E PARLAMENTIT TË GJERMANISË, PETER BAYER DHE CHRISTIAN SCHMIDT | FAQE 4-5

## Deputetët e Bundestagut: Gjermania kundërshton shkëmbimin e territoreve

Gjermania është kundër idesë për shkëmbimin e territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka deklaruar të hënën në Prishtinë deputeti i Bundestagut Gjerman, Peter Bayer, në një konferencë të përbashkët për medie me deputetin Christian Schmidt dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Ndërsa deputeti Christian Schmidt ka thënë se shkëmbimi i territoreve do të krijonte shumë probleme të reja të cilat do ta prekjin gjithë rajonin. Ata kanë mbështetur vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve duke kërkuar shtim të ritmit të këtij procesi. Deputetët e Bundestagut kanë shprehur gatishmërinë e Gjermanisë për ta mbështetur Kosovën në rrugëtimin për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian



**Sejdiu: Në prill nis projekti nacional për trajtimin e infarktut akut** | FAQE 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Erdogani humbet qytetet kryesore në Turqi

Sipas rezultateve të Komisionit Zgjedhor, kandidatët e partisë së Erdoganit, AKP, kanë humbur në Ankara, Izmir, Antali, Adana dhe Mersin. Opozita, po ashtu, është duke udhëhequr në garën për kryetar të Stambollit, ku Ekrem Imamoglu ka marrë 4 159 650 vota, kurse Binali Ildirim nga AKP-ja ka marrë 4 131 761 vota



"Partia do t'i apelojë rezultatet kurdo që ka nevojë", ka shtuar ai.

## "Kapitull i ri"

Erdogani është zotuar se Turqia tani do të fokusohet në ekonomi, teksa zgjedhjet kombëtare në këtë vend do të mbahen më 2023. "Ne jemi një kohë të gjatë përpara për të kryer reforma ekonomike pa kompromis në rregullat e tregut të lirë", u ka thënë ai gazetarëve.

Erdogani, lideri më i mirënjohur i Turqisë, prej themeluesit të republikës turke, Mustafa Kemal Ataturk, ka pasur mbështetje për shkak të rritjes ekonomike dhe ka gëzuar përkrahjen e kryesisht myslimanëve konservativë turq. Ai ka qenë njeriu më i famshëm gjatë fushatave, ndonëse ka ndryshuar politikën gjatë një periudhe të shkurtër, duke u kthyer nga një politikan modern, në një politikan me ambicie për ndryshim të

kushtetutës dhe transformim të presidencës ekzekutive, hap që ka alarmuar aleatët e tij perëndimorë, që kanë përmendur frikën për rritje të autoritarizmit në Turqi.

Prandaj, teksa Turqia po kalon në krizë ekonomike, si pasojë e rënies së vlerës së lirës dhe inflacionit në rritje prej 20 përqindësh, bashkë me numrin e rritur të papunësisë, votuesit duket se kanë qenë të gatshëm për ta ndëshkuar presidentin. "Këto zgjedhje janë historike sikur ato të vitit 1994", ka thënë gazetari Rusen Cakir përmes një postimi në "Twitter", duke iu referuar vitit kur Erdogan ishte zgjedhur kryetar i Stambollit. "Kjo tregon se një faqe që është hapur 25 vjet më parë, tani është duke u mbyllur", ka shtuar ai.

Teksa autoritetet kanë tentuar ta rrisin vlerën e valutës turke javën e kaluar, Erdogani ka thënë se Turqia do të tejkalojë këto probleme dhe se ai është "shefi" i ekonomisë. Megjithatë, bashkëpresident i

kompanisë për çështje politike, Teneo, Wolfango Piccoli, ka thënë se partia e AK e Erdoganit ka humbur shtatë nga 12 qytetet kryesore, pa numëruar Stambollin. "Kjo është natë e rëndë për partinë AK", ka thënë ai. "Ata nuk kanë punuar mirë në gjithë këtë situatë ekonomike. Për një parti që e konsideron vetën pro-biznesore, kjo është një çështje e madhe".

Në pjesën juglindore të Turqisë, të banuar kryesisht nga kurdët, banorët kanë festuar fitoren e partisë opozitare pro-kurde, Partia Demokratike Popullore, e cila ka fituar komunat, të cilat autoritetet i patën marrë nën kontroll dy vjet më parë, duke e akuzuar këtë parti për lidhje terroriste. Megjithatë, anëtarët e këtij grupi mohojnë se kanë ndonjë lidhje me Partinë Popullore të Kurdistanit. "Ata na kanë vjedhur neve dhe ne tani do ta përmbysim këtë gjë", ka thënë banori Abdullah Elmas për agjencinë e lajmeve "Reuters".

**ANKARA, 1 PRILL** - Partia e presidentit turk, Rexhep Taip Erdogan, ka humbur në zgjedhjet lokale kontrollin në qytetet më të mëdha në Turqi. Kandidatët e AKP-së kanë humbur në Ankara, Izmir, Antali, Adana dhe Mersin. Opozita, po ashtu, është duke udhëhequr në garën për kryetar të Stambollit, ka bërë me dije Komisioni Zgjedhor.

Kandidati i partisë kryesore opozitare turke Partia Popullore Republikane, në Stamboll është para kandidatit të AKP-së, ka bërë me dije Komisioni Zgjedhor.

Ekrem Imamoglu ka marrë 4 159 650 vota, kurse Binali Ildirim nga AKP-ja ka marrë 4 131 761 vota.

Në Stamboll priten rezultatet nga gjithsej 84 kuti të votimeve, të cilat ende nuk janë përpunuar për shkak të ankesave.

Erdogani, i cili ka dominuar në politikën turke, prej kur ka ardhur në pushtet 16 vjet më parë dhe ka udhëhequr këtë shtet me masa secilën herë më të ashpra, ka bërë fushatë intensive gjatë dy muajve të fundit për votimet e së dielës, të cilat i ka cilësuar si "çështje të mbijetesës" për Turqinë.

Megjithatë, marshet ditore të presidentit dhe mbështetja tejet e madhe në media nuk kanë arritur t'i sigurojnë fitoren partisë së tij në kryeqytet apo Stamboll, edhe për faktin që Turqia tani po përballet me recesion ekonomik. Mediet turke kanë thënë se kandidati i Partisë

Republikane Popullore (CHP), Mansur Yavas, ka shënuar fitore të qartë në Ankara, mirëpo rezultati ka qenë aq i ngushtë në Stamboll sa që të dyja partitë kanë pretenduar fitore. "Njerëzit kanë votuar në të mirë të demokracisë. Ata kanë zgjedhur demokracinë", ka thënë lideri opozitar, Kemal Kilicdaroglu, duke deklaruar se partia e tij ka CHP ka fituar Ankarën, Stambollin dhe Izmirin, qytetin e tretë më të madh në Turqi, ka njoftuar rfe. Humbja për partinë me bazë islamike të Erdoganit në Ankara ka qenë një shenjë e rëndësishme për presidentin. Humbja e Stambollit, vend në të cilin ka nisur karrierën e tij politike dhe ku ka shërbyer si kryetar në vitet 1990, mund të nënkuptojë një problem edhe më të madh për mbështetjen që gëzon ai.

Ndonëse lira turke pati një rritje të lehtë para zgjedhjeve, vlera e saj ka rënë sërish të hënën dhe ka qenë 1.2 përqind në krahësim me vlerën e dollarit amerikan prej 5.62.

Agjencia shtetërore e lajmeve Anadolu ka thënë se partia e Erdoganit do të apelojë rezultatit në disa distrikte të Ankarasë. Në një fjalim para mbështetësve të tij në Ankara, Erdogani ka pranuar humbjen në Stamboll, ndonëse ka thënë se shumica e lagjeve në këtë qytet do të udhëhiqen nga partia e tij. "Edhe nëse njerëzit tanë nuk na kanë dhënë udhëheqjen, ata i kanë dhënë distriktet partisë AP", është shprehur ai.


## Në Maqedoninë Veriore nis zyrtarisht fushata zgjedhore

**SHKUP, 1 PRILL** - Të hënën ka nisur zyrtarisht fushata e zgjedhjeve presidenciale dhe lokale të 21 prillit në Maqedoninë Veriore. KShZ-ja po bën përgatitjet e fundit për zbatimin e zgjedhjeve, ndërkohë që kandidatët për president kanë publikuar agjendën e aktiviteteve të tyre. Institucioni i zgjedhjeve bën apel te partitë politike për fushatë

korrekte. "U bëjmë apel të gjitha partive politike që përkrahin kandidatët, që edhe ata të jenë në nivelin e detyrimeve të tyre dhe të mos i shkelin normat ligjore dhe t'i respektojnë ato", tha Enver Salih, anëtar i KShZ-së.

Lista zgjedhore është mbyllur dhe të drejtë vote kanë gjithsej 1 808 131 qytetarë. Prej tyre, 1 726

696 do të votojnë në ditën e zgjedhjeve, kurse të tjerët janë në anekse të posaçme dhe do të votojnë një ditë përpara. Për arrijen e censusit prej 40 % në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale do të duhet të votojnë 723 252 persona. Të drejtë vote në diasporë kanë fituar 1 781 votues në 32 përfaqësi konsullore dhe diplomatike.



Tri vjet nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA)

# Apostolova: Taksa 100 për qind, në kundërshtim me parimet e MSA-së

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka deklaruar të hënën se vendosja e taksës ndaj produkteve të Serbisë është në kundërshtim me frymën e MSA-së. Në trevjetorin e nënshkrimit të MSA-së ajo ka thënë se BE-ja është e shqetësuar me këto barriera ndaj tregtisë së lirë. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka fajësuar shphen e diplomacisë së BE-së, Federica Mogherini, për të cilën ka thënë se ka shkaktuar trauma në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOÇI**

PRISHTINË, 1 PRILL - Qeveria e Kosovës edhe në trevjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) ka marrë kritika nga Bashkimi Evropian për vendosjen e taksës ndaj mallrave serbe. Në tryezën për shënimin e hyrjes në fuqi të MSA-së të organizuar nga Instituti EPIK, shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se taksa është në kundërshtim me frymën e MSA-së. "Tarifa doganore 100 për qind nuk është vetëm në kundërshtim me marrëveshjen e CEFTA-s, por është në kundërshtim edhe me parimet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkimi Evropian, si investuesi më i madh në Kosovë dhe partneri më i madh tregtar, është mjaft i shqetësuar dhe thekson se këto barriera ndaj tregtisë së lirë, oftoft të vendosura nga Kosova apo ndonjë shtet fqinj tjetër, pengojnë rrugën rajonale të integritimit ekonomik. Po ashtu, e bën vendin joatraktiv për investime të huaja", ka thënë Apostolova.

Ajo ka deklaruar se marrëveshja kërkon edhe përgjegjësi, duke përmendur edhe disa prej ngecjeve të Kosovës. "MSA-ja, jos të mirave, sjell edhe përgjegjësi. Për shembull, sot

bëhen tri vjet prej kur ka hyrë në fuqi MSA-ja dhe afati kohor për ta caktuar inventarin e ndihmës shtetërore sapo ka kaluar. Fatkeqësisht, në këtë drejtim ka pasur progres të vogël dhe i bëj thirrje Qeverisë së Kosovës të lëvizë përpara në këtë angazhim", është shprehur edhe fushat ku duhet të avancojë Kosova. "Kosova ka bërë hapa seriozë në fushën e konkurrencës dhe në të drejtat e pronësisë intelektuale por, pas dy vjetësh, Kosova duhet të garantojë edhe mbrojtje për të drejtat tregtare dhe industriale të pronësisë intelektuale sikurse në vendet e BE-së, përfshirë edhe metodat efektive për zbatimin e këtyre të drejtave", është shprehur ajo.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se Kosova ka hasur në disa vështirësi në lidhje me zbatimin e MSA-së, duke i ndërlidhur ato me dialogun dhe procesin e liberalizimit të vizave. "Janë disa vështirësi në kohët e fundit të ndërlidhura edhe me dialogun dhe proceset e tjera që kanë ndodhur. Megjithatë, ju siguroj se Qeveria e Kosovës nuk e ka hequr fokusin në zbatimin e MSA-së dhe punon ngushtë me të gjithë ekipin e ambasadores Apostolova në Kosovë, për zbatim të MSA-së, për vlerësim. Pra, jemi partnerë

të përditshëm", ka thënë ai. As në këtë tryezë kryeministri Haradinaj nuk ka lënë pa e përmendur përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, për të cilën ka thënë se ka shkaktuar trauma në procesin e dialogut me diskutimet për shkëmbim terriore. "Unë bëra shumë kujdes të mos e them se cilat janë vështirësitë, pse agjenda evropiane ka pengesa për t'u zbatuar. Por një vështirësi të madhe e kemi nga komisionarja Federica Mogherini, për faktin se ka devijuar dialogun me diskutimet për ndërrim të territorit. Na ka shkaktuar trauma politike të brendshme dhe në rajon. Fatkeqësisht, një pjesë e energjisë sime dhe Qeverisë time ka shkuar për të kundërshtuar një temë si kjo", ka thënë Haradinaj. Ndërsa ambasadorja e Finlandës

në Kosovë, Pia Stjernvall, ka deklaruar se Finlanda do ta mbështesë Kosovën në këtë rrugëtim. "BE-ja i ka ofruar Kosovës MSA-në dhe tani është me rëndësi të fokusohemi në zbatimin e saj jo për neve, por për qytetarët e Kosovës. Të gjithë qytetarët e Kosovës dëshirojnë një jete më të mirë për fëmijët e tyre dhe MSA-ja ju mundëson që të keni një shoqëri më të mirë, të barabartë dhe transparente. Finlanda, si dhe vende të tjera të BE-së, do të janë aty për t'ju mbështetur përgjatë këtij rrugëtimi", ka thënë Stjernvall. Gjatë tryezës Instituti EPIK ka prezantuar studimin për ndikimin dhe rëndësinë e MSA-së.

Gjatë prezantimit të studimit, drejtori ekzekutiv i Institutit EPIK, Demush Shasha, ka thënë se MSA-ja ka paraparë 31 detyrime specifike të cilat duhet të përmbushen përgjatë dhjetë

vjetëve të zbatimit. "MSA-ja ka vendosur kornizën ligjore për ndërmarrjen e reformave afatgjata strukturore për vitet në vijim, nga fusha e sundimit të ligjit, deri të kualiteti i sistemit arsimor. Po ashtu, MSA ka paraparë 31 detyrime specifike të cilat duhet të përmbushen përgjatë dhjetë (10) vjetëve të zbatimit të MSA-së. Ne shpresojmë se studimi ynë do të ofrojë kontribut modest për rritjen e vetëdijesimit për rëndësinë dhe përfitimet e MSA-së".

Marrëveshja Stabilizim Asocimi (MSA) hyri në fuqi më 1 prill 2016.

Në kuptimin politik, MSA-ja ka vendosur kornizën ligjore për avancimin e perspektivës evropiane të Kosovës. Në kuptimin ekonomik, MSA-ja ka hapur për bizneset e Kosovës tregun më të madh botëror tregtar.

## Kosova, shembull në rajon për trajtimin e komuniteteve joshumicë



PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën në takim komisionarin e Lartë të OSBE-së për Pakica Nacionale, Lamberto Zannier. Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova mbetet e përkushtuar për rritjen e harmonisë në mes të komuniteteve dhe për forcimin e paqes dhe stabilitetit. "Me kujdes e përcjelli vazhdimisht gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe jam i kënaqur me përpunimin. Kemi ndërtuar komizë ligjore që përkrah të drejtat e komuniteteve", u shpreh Thaçi.

Kreu i shtetit në takim me ambasadorin Lamberto Zannier ka folur edhe për rëndësinë e themelimit të Komisionit për të

Vërtetën dhe Pajtimin. "Është themeluar ekipi përgatitor për themelimin e këtij komisioni, që po përgatit kornizën ligjore dhe teknike. Ekipi përgatitor është duke zhvilluar fushatën e konsultimeve publike, me mbështetje të misionit të OSBE-së. Unë jam mirënjohës për misionin e OSBE-së që i ka dhënë mbështetje të plotë iniciativës dhe punës së ekipit përgatitor", ka thënë Thaçi. Ambasadori Lamberto Zannier ka mirëpritur angazhimet për avancimin e infrastrukturës ligjore për të drejtat e komuniteteve dhe ka shprehur gatishmërinë për të ofruar përkrahje për përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes komuniteteve

në Kosovë.

Lamberto Zannieri është takuar edhe me kryeministrin Ramush Haradinaj. Gjatë takimit, kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova ka kushtetutën më të avancuar sa iu përket të drejtave të minoriteteve dhe ka shënuar hapa konkretë në promovimin dhe avancimin e të drejtave të të gjitha minoriteteve dhe integritimin e tyre në institucionet e Kosovës. Haradinaj ka theksuar përkushtimin e Qeverisë për respektimin e plotë të të drejtave të komuniteteve, duke theksuar se Kosova mbetet shembull jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë për trajtimin e komuniteteve joshumicë.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim deputetët e Parlamentit të Gjermanisë, Peter Bayer dhe Christian Schmidt

# Deputetët e Bundestagut: Gjermania kundërshton shkëmbimin e territoreve

Gjermania është kundër idesë për shkëmbimin e territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka deklaruar të hënën në Prishtinë deputeti i Bundestagut Gjerman, Peter Bayer, në një konferencë të përbashkët për medie me deputetin Christian Schmidt dhe kryeministrin Ramush Haradinaj. Ndërsa deputeti Christian Schmidt ka thënë se shkëmbimi i territoreve do të krijonte shumë probleme të reja të cilat do ta preknin gjithë rajonin. Ata kanë mbështetur vazhdimin e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve duke kërkuar shtim të punës të këtij procesi. Deputetët e Bundestagut kanë shprehur gatishmërinë e Gjermanisë për ta mbështetur Kosovën në rrugëtimin për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian

vazhdojë mbështetjen për proceset zhvillimore në Kosovë dhe rajon në mënyrë që të krijohet klima e stabilitetit dhe prosperitetit për të gjitha vendet e rajonit. "Për neve është me rëndësi që të krijohet një zhvillim i mirë ekonomik në mënyrë që qytetarët të kenë vende të punës dhe po më vjen mirë që edhe kryeministri e potencoi këtë çështje. Falënderojmë Qeverinë e Kosovës dhe popullin e Kosovës për mikpritjen që në vazhdimësi ua kanë bërë ushtarëve dhe zyrtarëve tanë. Gjermania shpreh gatishmërinë që Kosova t'i bashkohet familjes evropiane dhe po punojmë për këtë", ka thënë deputeti gjerman Schmidt, duke shtuar se taksa ndaj produkteve serbe duhet të hiqet.

Ndërsa kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur angazhimin e Qeverisë së Kosovës për të krijuar një ambient të qëndrueshëm paqësor në rajon në bashkëpunim me të gjithë. Në këtë kontekst, kryeministri Haradinaj ka theksuar përkushtimin ndaj procesit të dialogut me Serbinë dhe angazhimin për arritjen e një marrëveshjeje që do të rezultojë me njohjen e ndërsjellë midis dy vendeve. "Ishte nder yni t'i presim dy deputetët gjermanë që janë me përvojë dhe përgjegjësi të gjatë politike dhe që kanë shprehur interesimin për Kosovën dhe rajonin në vazhdimësi. Në këtë takim biseduam për bashkëpunimin bilateral Kosovë - Gjermani që është në progres dhe mund të bëhet edhe më shumë. Konfirmova gatishmërinë time

**EPOKA  
ERE****Shqipe HETEMI**

**PRISHTINË, 1 PRILL** - Deputetët e Parlamentit të Gjermanisë, Peter Bayer dhe Christian Schmidt, të hënën kanë qëndruar për vizitë në Kosovë, me ç'rast janë pritur në takim nga kryeministri Ramush Haradinaj. Deputeti Peter Bayer ka bërë me dije se Gjermania e kundërshton fuqishëm idenë për shkëmbimin e territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve

duhet të vazhdojë me ritëm të shtuar.

Bayer është zotuar se Gjermania do të jetë partnere mbështetëse e Kosovës për proceset integruese. "Konfirmoj edhe një herë mirënjohjen tonë për pritjen tuaj. Këtu nuk jemi vetëm në vizitë, por jemi pranë miqve tanë, qytetarëve të Kosovës. Sigurisht se kemi biseduar për proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. Kemi folur për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë të cilin e mbështesim. Sa iu përket këtyre takimeve, ashtu siç tha edhe kryeministri, jemi të pajtimit

që dialogu duhet të vazhdojë dhe duhet të rritet. Kemi folur edhe për temën e shkëmbimit të territoreve dhe këtë ide Gjermania e kundërshton fuqishëm. Pra sa i përket shkëmbimit të territoreve, Gjermania e ka shumë të qartë qëndrimin dhe absolutisht është kundër kësaj ideje në të gjitha aspektet. Gjermania do të jetë partnere mbështetëse e Kosovës për proceset e ardhshme, por sigurisht me një sy kritik", ka deklaruar Bayer në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Haradinaj.

Ndërsa deputeti tjetër gjerman

Christian Schmidt ka thënë se ideja për shkëmbimin e territoreve do të krijonte shumë probleme të reja të cilat do ta preknin gjithë rajonin. "Nuk mund t'i zgjidhim problemet që i kemi përmes krijimit të problemeve të reja. Dhe ai që vërtet mendon se me këtë ide (shkëmbimin e territoreve) ta zgjidhë problemin, duhet të jetë shumë i vetëdijshëm se kjo ide do të krijonte shumë probleme të reja të cilat do ta preknin jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin në përgjithësi", është shprehur Schmidt. Ai ka thënë se shteti gjerman do ta



## Në 20-vjetorin e masakrës së Lybeniqit kërkohet drejtësi

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 1 PRILL** - Njëzet vjet më parë, më 1 prill 1999, forcat serbe vranë dhe masakruan 80 civilë të pafajshëm në Lybeniq të Pejës. Të ballafaquar me humbje të mëdha që po u shkaktoheshin pandërprerë, forcat policore dhe ushtarake serbe nëpër tërë vendin hakmerreshin mbi popullsinë civile shqiptare. Me rastin e 20-vjetorit të masakrës së Lybeniqit, të hënën, nën përkujdesjen e kryeministrit, është mbajtur akademi përkujtimore në Prishtinë. Në këtë akademi përkujtimore ka marrë pjesë edhe presidenti Hashim Thaçi, i cili ka thënë se muaji mars i viteve 1998, 1999 ishte muaji i heroizmit të luftës së Jasharëve, heroizmit të betejës së Gllogjanit dhe, gjithashtu, edhe me fillimin e bombardimeve nga NATO kundër ushtrisë dhe policisë serbe. Por, sipas tij, në këtë periudhë kanë ndodhur edhe shumë masakra anekënd Republikës së Kosovës nga

shteti i Serbisë. "Çdo ditë jemi anekënd Kosovës për t'i përkujtuar të rënë për liri, martirët dhe dëshmorët. Ishim së bashku me kryeministrin në Krushë të Vogël, edhe në Krushë të Madhe, i përkujtuam dëshmorët edhe në Celinë, Fortesë e vendbanime të tjera anekënd Republikës së Kosovës. Edhe në ditët në vijim do t'i përkujtojmë siç po përkujtojmë sot martirët dhe dëshmorët e Lybeniqit me rrethinë", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka theksuar se këto nuk janë vetëm emra vendbanimesh në kuptimin gjeografik, por janë bërë simbol i krimeve që shteti i Serbisë ka kryer në Kosovë kundër popullatës civile, në kohën kur largoi rreth 800 mijë shqiptarë dhunshëm nga Kosova dhe vrau mbi 13 mijë civilë shqiptarë. Sipas tij, ata u vranë vetëm për një arsye, vetëm pse ishin shqiptarë, vetëm pse e dëshironin lirinë, e dëshironin atë që e meritonin sikur të gjithë popujt e tjerë të qytetëruar. "Në Lybeniq u vranë të dashurit tuaj, famil-

jarët tuaj, farefisi juaj. U vranë në lulen e rinisë fëmijët, fëmijët deri në 18 muaj, shtatëvjeçar, u vranë gra shtatzëna, por një gjë u konstatua, se Serbia mund të vriste civilë, por nuk do të mund ta vriste kurrë idealin e lirisë dhe pavarësinë e Kosovës", ka theksuar ai.

Para familjeve të dëshmorëve, martirëve, përfaqësuesve institucionalë, presidenti Thaçi ka thënë se e kupton dhe e ndien dhimbjen e familjeve që e kanë çdo ditë. "I kuptoj dhe i ndiej lotët tuaj për të dashurit tuaj, por për aq sa është tragjike kjo masakër prej më të tmerrshmeve të shtetit të Serbisë në Lybeniq, në të njëjtën kohë duhet të qëndrojmë dinjitozë me integritet dhe krenarë për të kaluarën tonë të lavdishme", ka shtuar ai.

Në fund, presidenti Thaçi ka thënë se shteti i Serbisë ka kryer dhunë sistematike në Kosovë, ka kryer gjenocid në Kosovë. Por, sipas tij, "ajo që është shumë me rëndësi, ne fituam betejën, e fituam lirinë, vendi u çlirua, vendi është i pavarur". Ndërkaq kryeministri Ramush

Haradinaj gjatë fjalës së tij në këtë akademi ka thënë se është e çuditshme se si bashkësia ndërkombëtare është duke i mbyllur sytë karshi masakrave që kanë ndodhur në luftën e fundit në Kosovë "Është e çuditshme që bashkësia ndërkombëtare i ka mbyllur sytë përballë këtyre masakrave që kanë ndodhur në Kosovë. Çdo ditë marr letra nga familjarët që kërkojnë drejtësi. Mënyra më e mirë për ta vendosur të drejtën tonë është të mos harrojmë nga kemi ardhur. Plagët që kemi kaluar. Dhe për këtë duhet të punojmë që ta forcojmë atdheun", është shprehur Haradinaj, duke theksuar se nuk do të ndalen së kërkuari drejtësi për të gjithë të rënë dhe të pagjeturit.

Në emër të familjeve dhe banorëve të fshatit Lybeniq, ka folur Lendita Morina, e cila tha se pa praninë e baballarëve të masakruar nga paramilitarët serbë e kishin të vështirë ta përballonin jetën. Ajo ka theksuar se janë nënat e tyre që të vetme ndihmuan fëmijët t'i ndërtojnë ëndrrat e tyre për të jetuar.

që ta thellojmë këtë bashkëpunim. Shpreha falënderim për procesin e Berlinit, i cili po e ndihmon dhe po e ruan rajonin. Shpreha falënderimin për Gjermaninë dhe kancelaren Merkel për këtë iniciativë, e cila u dëshmuar me shumë interes për regjionin", ka deklaruar Haradinaj. Ai ka theksuar se Kosova dëshiron t'i bashkohet familjes evropiane përmes lëvizjes së lirë, për çka ka kërkuar edhe mbështetjen gjermane. "Kosova mbetet e angazhuar në të gjitha proceset e integritetit në strukturat euroatlantike dhe pret që angazhimi i saj për t'i përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara nga Komisioni Evropian ta marrë sa më shpejt liberalizimin e vizave për lëvizjen e qytetarëve të saj në vendet evropiane. Shpresojmë në vullnetin politik të shteteve kryesore të Evropës për ta përmbyllur këtë proces dhe jemi të vetëdijshëm se Qeveria e Gjermanisë ka rol të madh në këtë proces", është shprehur Haradinaj.

Ai ka vlerësuar gatishmërinë e dy vendeve për bashkëpunim ekonomik, duke përmendur Parkun Inovativ në Prizren dhe ka theksuar se Kosova angazhohet në krijimin e kushteve sa më të mira për investime. "Kosova ka një diasporë të madhe në numër në Gjermani dhe është e interesuar që ajo të jetë sa më e integruar në shoqërinë dhe shtetin gjerman që të kontribuojë në lidhjet sa më të fuqishme midis vendeve tona", ka deklaruar kryeministri Haradinaj. Në këtë takim ka qenë i pranishëm edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt.



## Gjykata Themelore refuzon kërkesën për pezullimin e pensioneve për veteranët

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka përsëritur vendimin e

Gjykatës Themelore të Prishtinës për refuzimin e kërkesës së Prokurorisë Speciale të Kosovës, e cila kishte kërkuar pezullimin e

pensioneve për më shumë se 19 mijë veteranë. "OVLUÇK-ja kërkon nga institucionet e drejtësisë, që hetimit të listave të veteranëve të luftës t'i

shkohet deri në fund, duke shqyrtuar në mënyrë individuale secilin rast", është thënë në komunikatën e OVLUÇK-së.



## Sejdiu: Në prill nis projekti nacional për trajtimin e infarktut akut



Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, në një konferencë për media mbajtur të hënën, ka folur për përmirësimin e kushteve në QKUK, për furnizimin me pajisje të reja për disa reparte, për trajtimin e pacientëve në mënyrë profesionale, si dhe për heqjen e listës së pritjes për magnet rezonancë dhe CT

shkaktohet panik te qytetarët që të mos trajtohen në QKUK, por në spitale private. "Në ambulancat e reja tani trajtohen 800 pacientë në ditë. Lajm i mirë është që brenda muajit do të fillohet një projekt nacional, ai i trajtimit në dy orët e para i infarktut akut. Të gjitha këto rezultate, që ka mjaft, ka pasur tendenca të individëve që të shkaktojnë panik te popullata dhe qytetarët me motive të ulëta, që pacientët tanë mos të trajtohen këtu, por në spitale private. E dimë që në QKUK ka qenë një zonë transite dhe brenda natës ka pasur individë që kanë referuar 16 pacientë për t'u trajtuar në spitale private. Ne nuk jemi kundër spitaleve private, mirëpo QKUK-ja duhet të jetë qendër referente që mban dyert e hapura, pavarësisht për

ata që kanë apo nuk kanë para", ka thënë Sejdiu. Ai ka thënë se janë duke bërë përpjekje të krijojnë kushte të mira për mjekë dhe pacientë. "Kemi rezultate të prekshme në shumë klinika, përveç infrastrukturës që po e zhvillojmë, furnizimit me pajisje, njëkohësisht edhe me atë të shërbimeve shëndetësore. Që nga shkurti i vitit të kaluar të gjithë pacientët trajtohen në Qendrën Klinike Universitare, duke përfshirë stentimin dhe operacionin në zemër. Në Klinikën e Radiologjisë është lajm i mirë që magnet rezonanca, ku lista e pritjes ka qenë një vit, tani është reduktuar në një javë. Kurse sa i përket CT-së nuk ka më listë të pritjes", ka thënë Sejdiu. Ai ka theksuar se për aq kohë sa do të jetë në krye të SShKUK-së,

pacientët do të trajtohen në mënyrë profesionale dhe të sigurt.

Ndërkaq drejtor i Kardiologjisë, Tefik Bekteshi, ka treguar për rastet që janë kryer në vitin 2018. Ai ka thënë se tani janë në funksion dy salla që punojnë në kardiokirurgji. "Në vitin 2018 janë kryer 1 370 procedura. Në këtë vit kemi 720 koronarografi dhe 350 stentime, mirëpo në Kardiologji vitin e kaluar ka pasur 212 operacione, ndërsa në këta tre muaj 56 operacione. Vdekshmërinë tek infarkti akut e kemi pasur në 3.58. Kemi dy salla që tani punojnë në Kardiokirurgji. Kemi një zhvillim progresiv me rezultate të drejta. Vdekshmëria prej 15 përqindësh fare nuk qëndron sa i përket Kardiokirurgjisë Invazive", ka thënë Bekteshi.

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 PRILL - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), Basri Sejdiu, ka mbajtur të hënën konferencë për medie, në të cilën ka folur lidhur me përmirësimin e kushteve në QKUK, furnizimin me pajisje të reja për

disa reparte, trajtimin e pacientëve në mënyrë profesionale si dhe për heqjen e listës së pritjes për magnet rezonancë dhe CT. Ai ka treguar se në ambulancat e reja trajtohen deri në 800 pacientë në ditë. Sejdiu ka bërë me dije se brenda muajit prill pritet të fillojë një projekt nacional për trajtimin e infarktut akut. Ai ka thënë se ka pasur tendenca nga disa individë që të

## Sot përkujtohen dëshmorët e '81-s, Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Me rastin e 38-vjetorit të rënies në ballë të demonstratave të vitit 1981 të dëshmorëve Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva, të martën, më 2 prill 2019, në orën 12:00, do të bëhen homazhe në nderim të jetës

dhe veprës së tyre. Homazhet do të bëhen te vendi i rënies së tyre, pllaka përkujtimore, afër objektit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Prishtinë.

Naser Hajrizi dhe Asllan Pireva ishin militantë të organizuar të

lëvizjes çlirimtare të kohës dhe organizatorë të të rinjve në demonstratën e mëngjesit të 2 prillit 1981 në qendër të Prishtinës. Ata u vranë nga të shtënat e oficerëve ushtarakë, të vendosur gjatë natës në objektin e Bankës Popullore.



# Katër shtetet e vogla të Evropës Juglindore mund të bëjnë një bashkësi të fuqishme



**Dr. Bajram KOSUMI**

Shtetet e vogla të Evropës Juglindore, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Mali i Zi, ende janë duke e ndërtuar themelin dhe vizionin për epokën e re të shekullit XXI. Unë do ta diskutoj jo një projekt për të ardhmen e tyre, së pakut ende jo një projekt, po vetëm një vizion personal, pak më ndryshe nga politika tradicionale. Meqenëse do t'i përmendim shpesh këto katër shtete, me dashamirësi do t'i quaja me emërtimin "katër shtetet e vogla". NATO sigurisht që është faktori më i rëndësishëm i sigurisë për katër shtetet e vogla. Në anën tjetër, BE është një faktor strategjik për të ardhmen e tyre, sado procesi i integritetit të këtyre vendeve në BE po ecën me shumë vështirësi.

Pyetja e parë që shtrihet për katër shtetet e vogla është: a është kjo koniunkturë e tashme sigurie e politike e mjaftueshme për to? Pyetja e dytë është: a mund të bëjnë katër shtetet e vogla diçka më shumë për të ardhmen e tyre? Përgjigja në pyetjen e parë është më e thjeshtë. Gjatë tranzicionit të gjatë në kapërcyell të shekujve XX-XXI në katër shtetet e vogla është fetishizuar roli i NATO-s dhe i BE. Muajt të mjalitit po i duket fundi. Në vitin 2018 presidenti Trump pyeti për interesin e NATO-s ndaj shteteve të vogla në këtë pjesë të Evropës, pyeti pse duhet t'i dërgojë trupat e tij në Mal të Zi nëse malazetët hyjnë në luftë me Rusinë, dhe kërkoi më shumë financa për ombrellën e sigurisë. Po në vitin 2018 Britania e Madhe filloi Brexit-in, ndërsa liderët evropianë shfaqën pikëpamje deri edhe të kundërta për vlerat themelore të BE (si për politikën e migracionit, refugjatët e demokracinë), me çka vunë në dyshim themelet e BE.

Në këtë situatë katër shtetet do të duhej të fillonin një proces të përkufizimit të interesave strategjike. Pavarësisht prej disa hapave progresivë, si marrëveshja Greqi-Maqedoni, situata e brishtë, në radhë të parë e sigurisë, vazhdon të zgjasë në EJT dhe, po të mos ishte NATO, sigurisht situata do të merrte rrjedha tjera. Serbia vazhdon të ketë marrëdhënie armiqësore ndaj Kosovës dhe marrëdhënie të tendosura me tri shtetet e tjera, pa fshehur në asnjë rast apetitet pushtuese e hegjemone. Rusia është duke provuar të depërtojë në politikën e katër shteteve në shumë mënyra, ashtu sikurse në gjithë këtë pjesë

të Evropës. Një faktor tjetër, gjithnjë e më kërcënues për botën, është edhe terrorizmi ndërkombëtar, për të cilin katër shtete të vogla janë terren i kërkuar.

Si mund t'u rezistojnë katër shtetet e vogla këtyre zhvillimeve?

Përgjigja në këtë pyetje na qon në radhë të parë te pyetja: cili është potenciali i katër shteteve të vogla në këtë rrethanë të re?

Katër shtetet e vogla kanë një potencial të vogël njerëzor: nga 630 mijë banorë, sa ka Mali i Zi, deri në 3 milionë banorë sa ka Shqipëria.

Ushtritë e këtyre shteteve të vogla nisin nga 2500 sa ka Kosova dhe po aq Mali i Zi deri në 9000-10000 sa kanë Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria. Asnjëra prej ushtrive të vogla të këtyre katër shteteve nuk mund të jetë garanci e sigurisë së vendit nga cilido shtet mesatar rajonal apo evropian, natyrisht nëse Trump hamendet se pse duhet NATO ta mbrojë Malin e Zi. Katër shtetet tona kanë territor të vogël, tregje të vogla, me një ekonomi jo shumë të zhvilluar. Bruto produkti i katër shteteve shkon nga rreth 5 miliardë dollarë sa e ka Mali i Zi, deri në 13 miliardë sa ka Shqipëria. Ekonomia e secilit prej katër shteteve mbetet në mëshirën e cilitdo shtet mesatar evropian, apo si e tha kryeministri bullgar në Samitin e BE Sofje në vitin 2018, bruto produkti i të gjitha shteteve të vogla të EJT nuk bën sa ai i Çekisë (215 miliardë dollarë).

Pjesa më e madhe e buxhetit të katër shteteve të vogla shkon në pagat e administratës shtetërore, të domosdoshme për çdo shtet, por barrë e madhe për secilin nga shtetet e vogla.

Dhe në fund, në çdo 100 kilometra pret radhën në një kufi! Një shkujtan kalon tre kufi për të mbërritur deri në plazhet e Ulqinit, në një gjatësi ajrore jo më shumë se 200 kilometra. Një korçar duhet të kalojë dy kufij për të ardhur në Prishtinë në një gjatësi rrugore më pak se 200 kilometra. Edhe optimistët më të mëdhenj mund të zhgënjehen.

Atëherë, çka mund të bëjnë katër shtetet për një të ardhme më të mirë për qytetarët dhe veten e tyre? Kjo është pyetja e dytë, përgjigja e së cilës nuk mund të jepet lehtë. Unë vetëm po përmend disa mundësi për të ecur përpara, por shpresoj që me kohë do të ketë një vizion më real dhe më progresiv.

Me një marrëveshje të mundshme midis katër shteteve të vogla për politikën e jashtme dhe diplomacinë, në vend të 28 ambasadave sa ka Mali i Zi deri në 37 ambasadave sa ka Shqipëria (Maqedonia e Veriut dhe Kosova kanë midis këtyre shifrave), mund t'i kishin 126 ambasadave, me kusht që një ambasadë të prezantojë katër shtetet. Sa shumëfish do të zvogëloheshin shpenzimet për

ambasada dhe sa shumëfish do të mbulohej bota me përfaqësimin e katër shteteve!

Nëse këto katër shtete krijojnë një treg të përbashkët, pa barriera politike e doganore, bruto produkti i tyre do të bëhej 35 miliardë dollarë, i aftë për të konkurruar në tregun evropian dhe në atë botëror. Do të krijohej një hapësirë me 78.783 kilometra katrorë dhe me 7 milion e gjysmë banorë.

Supozo një marrëveshje për kalimet kufitare të njerëzve dhe të mallrave pa pika kufitare. Sa shpenzime do të uleshin dhe sa koha do të shpëtohej?

Supozo një marrëveshje për riorganizim e ushtrive të vogla të katër shteteve, nën ombrellën e NATO-s: do të krijohej një ushtri e koordinuar prej 30.000 ushtarëve. Dhe kështu, plot marrëveshje të tjera.

Nuk do të thotë kjo që të krijohet një konfederatë klasike, madje pikërisht e kundërta, të krijohet një konfederatë moderne, ku secili shtet ruan sovranitetin e vet, por në çështjet ku mund të veprojnë si një trup, ta bëjnë këtë, fillimisht duke bërë marrëveshje katërpalëshe për çështje të caktuara.

Pse mund të funksionojë një konfederatë moderne, kur nuk ka funksionuar Federata Jugosllave? Sepse në këtë bashkësi nuk ka asnjë shtet të madh e hegemon, që do t'i kërcënonte të tjerët. Asnjëri prej shteteve nuk do të

frikësohej prej tjetrit. Katër shtetet e vogla janë pak a shumë me potenciale të barabarta dhe nuk kanë asnjë ambicie hegjemone ndaj njeri tjetrit.

Pse mund të krijohet një konfederatë moderne kur shqiptarët janë pjesë përbërëse e secilit shtet dhe si komb shumicë? Sepse pikërisht shqiptarët kanë interes strategjik për të ruajtur pavarësinë dhe marrëdhëniet miqësore me Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, mu për shkak të faktorit shqiptar në ato shtete dhe për shkak të apetiteve hegjemone të Serbisë dhe politikave ndikuuese të të tjerëve.

Pse Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi kanë interes për një konfederatë të tillë? Sepse që të dy shtetet do të krijonin një mekanizëm sigurie, pa rrezikuar asgjë, ndaj politikave jo qëllim mira të fqinjëve dhe të apetiteve ruse. Edhe Maqedonia e Veriut edhe Mali i Zi e kuptojnë se në një bashkësi të barabartë me shqiptarët (Shqipëria e Kosova) mund të jenë të pavarur e të sigurt, ndryshe, katër shtetet e vogla do të jenë pre e ambicieve të të tjerëve.

Po ashtu, në një bashkësi do të paqësoheshin më shumë mospajtimet nacionale të së kaluarës dhe do të eliminohej problemi Kosovë-Serbi. A nuk e kanë dëshmuar në dhjetë vjetët e fundit katër shtetet se kanë marrëdhënie shumë të mira me njëri

tjetrin?

Në fund, pse një konfederatë moderne në raport me BE? Së pari, BE-ja pas Brexit-it ka hyrë në një rrugë të re të ri-përkufizimit. Së dyti, katër partnerët të vegjël nga një nuk paraqiten si faktorë për BE, ndërsa një konfederatë moderne paraqet faktor shumë të rëndësishëm.

Me këto marrëveshje do të uleshin shpenzimet e mëdha administrative dhe paratë e kursyera do të investoheshin në shërbimet publike. Do të krijohej një mekanizëm i brendshëm i sigurisë dhe asnjë shtet fqinj e as më i largët nuk mund të sillet me kërcënim ndaj katër shteteve të vogla.

Nga një rajon i brishtë dhe gjenerim konfliktesh, do të krijohej një rajon i zhvilluar ekonomik, që gjeneron stabilitet, siguri dhe zhvillim ekonomik.

Natyrisht, ky është vetëm një vizion imi për rajonin tonë të trazuar me shekuj. Por, nëse liderët e katër shteteve të vogla përcjellin me vëmendje politikën e jashtme të Aleksandër Vuçiqit, të Milorad Dodikut, si dhe ambiciet ruse për EJT, ata duhet të veprojnë shpejt në këtë drejtim.

*(Autori ka qenë kryeministër i Kosovës. Ideja është shpalosur në "Balkan Leadership Conference", organizuar nga Universal Peace Federation, Tiranë, 2019)*



Shoqata e të Burgosurve  
Politikë e Kosovës



SHOQËRIA  
LËVIZJA



## AKADEMI PËRKUJTIMORE

**F T E S Ë**  
Znj/Z .....

Ftohemi të merrni pjesë në Akademinë përkujtimore, në 5-vjetorin e vdekjes së veprimtarit atdhetar,  
**Bali Dervishi.**  
I burgosuri politik, Bali Dervishi, organizator i demonstratave të vitit 1981 në Vushtri, i cili tërë jetën e kishte vënë në shërbim të bashkimit kombëtar!

Akademia përkujtimore mbahet më **3 prill 2019**, ora **12:00**, në Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Ju mirëpresim!

Këshilli organizues

## Më 3 prill mbahet akademi përkujtimore kushtuar veprimtarit Bali Dervishi

**PRISHTINË, 1 PRILL** - Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës dhe Lëvizja Shoqëria kanë bërë me dije se më 3 prill mbahet akademi përkujtimore kushtuar

veprimtarit Bali Dervishi me rastin e pesëvjetorit të vdekjes së tij. Kjo akademi do të mbahet në orën 12:00 në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Bali

Dervishi ishte organizator i demonstratave të vitit 1981 në Vushtri. Veprimtari Dervishi tërë jetën e kishte vënë në shërbim të bashkimit kombëtar.

# MTI-ja financon Zonën Ekonomike në Lipjan me 500 mijë euro

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka paraparë 500 mijë euro për financimin e Zonës Ekonomike në Lipjan, ndërsa Komuna e Lipjanit ka participuar me një shumë simbolike prej 50 mijë eurosh



Ndërsa kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka thënë se i rëndësishëm është vazhdimi i ndërtimit të Zonës Ekonomike, e cila do të krijojë mundësi të reja

për zhvillimin e afarizmit në këtë komunë. "E rëndësishme është që po vazhdohet ndërtimi i Zonës Ekonomike, e cila do të krijojë mundësi të reja për ta

zhvilluar afarizmin. E falënderoj shumë ministrin Shala që ka mundësuar financimin e kësaj Zone Ekonomike", ka thënë Ahmeti.

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

**LIPJAN, 1 PRILL** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, për financimin e Zonës Ekonomike në vlerë prej 500 mijë eurosh. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka paraparë 500 mijë euro për këtë fazë të ndërtimit të Zonës Ekonomike në Lipjan, ndërsa Komuna e Lipjanit ka participuar me një shumë simbolike prej 50 mijë eurosh. Ministri Shala ka theksuar se ky memorandum mundëson bashkëfinancimin e Zonës Ekonomike të Lipjanit duke kryer procedurat e ndërtimit. "MTI-ja është zotuar se do t'i nisë të gjitha procedurat për ndërtimin e infra-

strukturës në këtë Zonë Ekonomike që të jetë funksionale për bizneset të cilat do të akomodohen në këtë zonë dhe që do të ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit", ka theksuar Shala. Ai u shpreh se ministria të cilën e drejton është e përkushtuar në dy fusha për përkrahjen e bizneseve. "Për krijimin e infrastrukturës ligjore dhe përmirësim të kushteve të të bërit biznes në Kosovë, si dhe për përmirësimin e kushteve fizike apo infrastrukturës që bizneset ta kenë më të lehtë operimin dhe funksionimin", ka thënë Shala. Ai ka shtuar se kjo Zonë Ekonomike parashihet të kushtojë 2.8 milionë euro, ku deri më tani janë financuar mbi një milion euro. "Besojmë se ky përkushtim do të vazhdojë të funksionalizohet në tërësi në këtë zonë", ka thënë Shala.

## Rritja e eksporteve të Kosovës në drejtim të tregut të BE-së, ende larg niveleve të dëshiruara

**PRISHTINË, 1 PRILL (ER)** - Ka shumë përfitime që dalin nga Marrëveshje e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për ekonominë e Kosovës, megjithatë rritja e eksporteve kosovare në drejtim të tregut të BE-së është ende larg niveleve të dëshiruara. Kështu u tha të hënën në tryezën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, e titulluar "Rritja e përfitimeve të BE-së", ku u diskutua në lidhje me përbushjen e obligimeve që dalin nga MSA-ja, por edhe për përfitimet në aspektin ekonomik nga kjo marrëveshje.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se kjo marrëveshje përbën një kornizë mjaft të vlefshme që duhet të shfrytëzohet nga ana e bizneseve të sektorëve të ndryshëm, duke theksuar se pritshmëritë kanë qenë shumë më të larta në kohën kur është nënshkruar.

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka deklaruar se arritja e kësaj marrëveshjeje, e cila është e para kontraktuale në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, parasheh fuqizimin e demokracisë, rritjen e bashkëpunimeve ndërkom-



bëtare, promovimin e bashkëpunimit rajonal, zhvillimin ekonomik etj. Po ashtu, Hoxha ka thënë se zbatimi i gamës së gjerë të reformave që përfshijnë përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së si dhe rritja e qasjes së bizneseve në tregun evropian janë kyçe për

maksimizimin e përfitimeve që dalin nga MSA-ja. Ministrja Hoxha ka shtuar se institucioni që ajo drejton do të vazhdojë ta koordinojë zbatimin e obligimeve që dalin nga zbatimi i MSA-së si dhe Agjendën për Reforma Evropiane, duke shtuar se kjo marrëveshje tashmë ka

rezultuar në zhvillime pozitive direkte si dhe indirekte, duke përmendur rritjen ekonomike, rritjen e eksportit, investimeve të huaja dhe të hyrave buxhetore. Përfaqësuesit e bizneseve, që ishin pjesë e panelit, folën për sfidat dhe për mundësitë me të cilat ata përballen pas hyrjes në fuqi të

Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim (MSA), duke dhënë edhe rekomandimet e tyre lidhur me atë se çfarë duhet të bëjnë institucionet e shtetit për të ndihmuar për informim më të mirë të bizneseve për përfitimet e MSA-së si dhe për fuqizimin e kapaciteteve të tyre.



## Mbahet ankandi i pestë i letrave me vlerë për vitin 2019

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Ministria e Financave (MF) ka njoftuar se më 8 prill do të mbahet ankandi i pestë me radhë për vitin 2019. Në këtë ankand do të emetohen

obligacione me maturitet dyvjeçar në shumën prej 25 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku intere-

si i përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (2 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave. Sipas

MF-së, për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra prej bankave komerciale që operojnë në Kosovë.



# Lluka në Bukuresht shpalosi problemet që Serbia po ia shkaktton Kosovës



PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, po merr pjesë në takim e nivelit të lartë të ministrave rreth "Konektiviteti energjetik i Evropës qendrore dhe juglindore" e cila po mbahet në Bukuresht të Rumanisë.

Ministri Lluka gjatë fjalimit të tij iu drejtua komisionarit për veprime klimatike dhe të energjisë, Miguel Arias Canete, ministrit të Energjisë të Rumanisë, Anton Anton, drejtorit gjeneral të "DG Energy" pranë Komisionit Evropian,

Dominique Ristori dhe të gjithë të pranishmëve, duke i adresuar problemet të cilat Serbia po i shfaq karshi Kosovës e të cilat po pengojnë lidhjen e Kosovës me Evropë dhe rajon. "Dua ta ngreh një çështje e cila jo vetëm është relevante në implementimin e projektit të lidhjes së tregjeve mes Shqipërisë, Italisë, Malit të Zi dhe Shqipërisë (AIMS), por është një kusht paraprak për rregullimin e tregut rajonal. Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë në takimin e fundit

ka konkluduar 'shkelje të rëndë të vazhdueshme' nga ana e Serbisë në lidhje me menaxhimin e kongestionit të aplikuar në interkonektivitetin e Kosovës. Një konkluzë e tillë, nëse nuk korrigjohet, hyn në efekt në qershor të këtij viti", ka thënë ministri Lluka.

Ai ka kërkuar që të zgjidhet sa më shpejt ky problem me Serbinë që po e dëmton konsumatorin e Kosovës me çmime të larta. "Konsumatorët e Kosovës kanë mbajtur barrën e tarifave më të shtrenjta të

importit për shkak të barrierave dhe të drejtave ekskluzive të pjesëmarrësve serbë në treg të cilët mund të operojnë në tregun e Kosovës" u shpreh ministri Lluka. Ai ka treguar se Kosova ka marrë hapa konkretë për bashkimin e tregjeve dhe ka kërkuar që Kosova të jetë pjesëtare e barabartë në projektin AIMS. "Në lidhje me bashkimin e tregjeve, Kosova është duke punuar me Shqipërinë në projektin Ballkani Perëndimor 6 (WB6). Projekti ka avancuar dhe së

shpejti presim ta themelojmë shkëmbimin e energjisë me Shqipërinë e cila do të administrojë këto dy tregje të bashkuara. Në pikëpamjen tonë, ky projekt duket të konsiderohet hap i parë në bashkimin e tregjeve të AIMS, që në këtë rast duhet të përfshijë edhe tregun e Kosovës", është shprehur Lluka.

Në fund ai ka pohuar se përfshirja e Kosovës në këtë projekt do ta lehtësonte tranzicionin energjetik në një treg të vetëm evropian.

## 'Norwegian Air' lanson linjën direkte Stokholm - Prishtinë - Stokholm

PRISHTINË, 2 PRILL (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari' ka shtuar edhe një linjë direkte në listën e destinacioneve të shërbyera. Nga sot (e martë) 'Norwegian Air' do të lansojë linjën Stokholm - Prishtinë - Stokholm e cila do të jetë çdo të martë. Nisjet nga Stokholmi do

të bëhen në orën 10:15, me arritje në Prishtinë në orën 13:35, ndërkaq nisjet nga Prishtina do të bëhen në orën 14:25, me arritje në Stokholm në orën 18:00, kohë lokale. "Ne në vazhdimësi jemi duke bërë përpjekje për të shtuar linja të reja në mënyrë që të ofrojmë mundësi sa më të favorshme

për udhëtarët tanë", ka deklaruar Haldun Firat Kokturk, drejtor gjeneral i 'Limak Kosovo International Airport J.S.C'.

Kompania ajrore 'Norwegian Air' është një ndër kompanitë më të vlerësuara në Evropë që operojnë me kosto të ulët, e cila fluturon në mbi 150 destina-



## Ish-kongresisti amerikan bën homazhe në Kompleksin Memorial 'Adem Jashari'

SKENDERAJ, 1 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i shoqëruar edhe nga kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kanë prituri të hënën në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz ish-kongresistin amerikan Jerry Weller. Ish-kongresisti ka bërë homazhe te varri i komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari dhe të rënëve të tjerë në kompleks.

Më pas, ata kanë vizituar edhe hapësirat e kullës së rezistencës të familjes Jashari, ku ciceroni zyrtar i ka rrëfyer Wellerit luftën e 5, 6 dhe 7 marsit të vitit 1998. Para se të largohet nga Prekazi, ish-kongresisti ka vizituar edhe Muzeun në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", ku kryetari Bekim Jashari i ka dhuruar mikut amerikan një libër historie për luftën e Jasharëve në gjuhën angleze.



## Haziri dhe drejtori i KEDS-it konfirmojnë bashkëpunim në efikasitet të energjisë

GJILAN, 1 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, me bashkëpunëtorë ka prituri në një takim pune drejtorin e KEDS-it në Kosovë, Alper Erbas, të cilin e kanë konfirmuar për bashkëpunimin e plotë në projekte të përbashkëta në kuadër të efikasitetit të energjisë. Haziri ka thënë se ky takim është në kuadër të bashkëpunimit për furnizim të rregullt me energji, njëkohësisht edhe për realizimin e projekteve të

përbashkëta në efikasitet të energjisë. "Komuna e Gjilanit edhe më parë ka kërkuar bashkëpunim me KEDS-in dhe ai është konfirmuar sot me një vendosmëri të plotë që të gjitha projektet që pikëprekin institucionet mes vete dhe interesat e përbashkëta për qytetarin dhe afarizmin, të bëhen në koordinim të plotë. Drejtori, gjithashtu, ka konfirmuar edhe investime të tjera në vazhdimësi sikur deri më tani

dhe kjo do të bëhet në bazë të prioritetëve", ka thënë Haziri. Kurse drejtori i KEDS-it, Alper Erbas, pasi e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen miqësore, ka thënë se kompania do të jetë e orientuar, përpos furnizimit të rregullt me energji elektrike, edhe për projektet në digjitalizim, efikasitet, investim të përbashkët të projekteve komunitare dhe projekte të tjera që kanë të bëjnë me kushtet më të mira.



## Komuna e Mitrovicës u kërkon falje qytetarëve për mungesën e certifikatave

MITROVICË, 1 PRILL (ER) - Drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale. Në këtë mbledhje drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka bërë me dije se edhe gjatë kësaj fundjave inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë inspektuar subjektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës. Ai ka thënë se vendimi i kryetarit Bahtiri, që dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha bizneset në Mitrovicë, është duke u respektuar në përpikëri. Ndërsa drejtori i

Administratës, Hysen Muzliukaj, ka njoftuar ekzekutivin se Agjencia për Regjistrimin Civil, organi më i lartë i gjendjes civile në Republikën e Kosovës, ka dërguar një njoftim për të gjitha zyrat e gjendjes civile nëpër komunat e Kosovës, që në mungesë të formularëve (dokumente të gjendjes civile), me qëllim të realizimit të të drejtave të qytetarëve për pajisje me dokumente të gjendjes civile, nga data 28. 3. 2019, të fillohet lëshimi i dokumenteve me letër të bardhë nga sistemi i gjendjes civile. Me këtë rast, drejtori Muzliukaj kërkon falje nga të gjithë qytetarët e Mitrovicës për mungesat e formularëve, që nuk është e varur nga kjo komunë, por nga ministria. Megjithatë, shërbimi për qytetarët do të vazhdojë të mbetet një prej prioritetëve më të rëndësishme.



## Hoti e Begaj bisedojnë për garat e nivelit komunal në Malishevë

MALISHEVË, 1 PRILL (ER) - Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, i shoqëruar nga zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Leonora Morina-Bunjaku, është takuar me kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Gjatë këtij takimi ata kanë biseduar për Programin Nacional për Rininë dhe për mbarrëvajtjen e garave të kreativitetit kulturor dhe mendimit kritik në Komunën e Malishevës. Koordinatorin Hoti u interesua për ecurinë e garave në kreativitet

kulturor dhe mendim kritik në nivel shkolle dhe atë komunal që po mbahen tani. "Shkollat e Komunës së Malishevës janë duke i dërguar rezultatet e garave në nivel shkolle në kreativitet kulturor dhe mendim kritik, mirëpo unë jam i interesuar të mësoj edhe nga ju si kryetar i Malishevës për mbarrëvajtjen e këtyre garave. Tashmë kanë filluar garat e nivelit komunal, andaj shfrytëzoj rastin t'u uroj suksese të gjithë nxënësve që janë pjesë e kësaj gare", ka thënë koordinatori Hoti. Ndërsa kryetari Begaj ka thënë se është i kënaqur me procesin e garës në nivelin e shkollës në

komunën që ai udhëheq dhe u zotua se do të ofrojë mbështetje për garat në nivelin komunal. "Garat e nivelit shkolle kanë shkuar mirë dhe shpresoj se edhe në nivelin komunal do të tregojmë suksese në këto gara. Unë si kryetar komune e ofroj gjithë mbështetjen time. Nëse është nevoja punoj edhe natën për realizimin e suksesshëm të këtyre garave në nivelin komunal", ka thënë Begaj. Garat në kreativitet kulturor dhe mendim kritik në nivel komune kanë filluar të mbahen nga 30 marsi dhe do të vazhdojnë deri më 13 prill.



## Haradinaj: Mekanizmat e sigurisë të jenë vigjilente, qytetarët të kujdesshëm

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e mekanizmeve të sigurisë së vendit, me të cilët ka biseduar për zhvillimet e përgjithshme në vend, me theks të veçantë për dukurinë e zjarreve në territorin e Kosovës.

Kryeministri Haradinaj, duke i cilësuar si veprime të rrezikshme që mund të kenë pasojë të paparashikuara, kërkoi që të rritet vigjilenca për një informim të

shpejtë, të ndërsjellë si dhe koordinim të dy niveleve të pushtetit, atij lokal dhe qendror me mekanizmat relevantë të sigurisë së vendit për menaxhim dhe vënie nën kontroll dhe shuarje të zjarreve.

Kryeministri Haradinaj ka falënderuar krerët e mekanizmeve të sigurisë së Kosovës si dhe KFOR-in për reagimin adekuat, kurse nga qytetarët ka kërkuar që të jenë të kujdesshëm duke parandaluar dhe lajmëruar zjarret.



## Mbështetja e shteteve anëtare të BE-së, kyçe për përmbylljen e suksesshme të dialogut



PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka pritur të hënën në takim emisaren e veçantë për Ballkanin Perëndimor nga Ministria e Jashtme e Çekisë, Janina Hrebickova, me të cilën ka diskutuar për sfidat e rajonit në rrugën e integrimit evropian. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka falënderuar emisaren Hrebickova për mbështetjen e Çekisë në rrafshin bilateral ndër vite, ndërsa është zotuar se Kosova është e përkushtuar për thellimin e marrëdhënieve në fusha të interesit të përbashkët. Në këtë takim të dyja palët diskutuan për perspektivën evropiane të rajonit, në veçanti për ecurinë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Hoxhaj ka thënë se Kosova është e përkushtuar për përmbylljen e shtetndërtimit, duke arritur mar-

rëveshje finale me Serbinë, e cila përmban njohje të ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka theksuar se mbështetja e Çekisë dhe e vendeve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian për këtë proces është jashtëzakonisht e rëndësishme. "Me emisaren e veçantë për Ballkanin Perëndimor nga Ministria e Jashtme e Çekisë, Janina Hrebickova, diskutuam për perspektivën evropiane të rajonit dhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Marrëveshja finale duhet ta sjellë njohjen e ndërsjellë si dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Mbështetja e Çekisë dhe e shteteve anëtare të BE-së është jashtëzakonisht e rëndësishme për përmbylljen e suksesshme të këtij procesi", ka thënë Hoxhaj.

## Luan Latifi caktohet ushtrues detyre për kryeshef ekzekutiv të KPM-së

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më 29 mars ka mbajtur mbledhje, në të cilën anëtarët e Komisionit të KPM-së morën vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës të kryeshefit ekzekutiv Luan Latifi, aktualisht drejtor i Departamentit të Monitorimit dhe Analizës, për të kryer këtë funksion deri në përmbylljen e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të kryeshe-

fit ekzekutiv me mandat ligjor. "Vendimi për caktimin e z. Latifit për ushtrues të detyrës së kryeshefit ekzekutiv është bazuar në kualifikimet profesionale adekuate të cilat janë në pajtim me fushën e rregullimit të mediave me të cilën merret KPM-ja si dhe duke u bazuar në rezultatet e tij gjatë përvojës së tij udhëheqëse në KPM, që nga viti 2003, duke qenë pjesë e proceseve të rëndë-

sishme zhvillimore në KPM", është thënë në njoftimin për media të KPM-së.

Luan Latifi është i lindur në Gjilan më 2 nëntor 1975. Studimet themelore i ka përfunduar në Prishtinë, Fakultetin Filozofik - drejtimin Sociologji, ndërsa studimet master i ka përfunduar në Gazetari, në Institutin Kosovar për Gazetari dhe Komunikim (KIJAC).



## Kompozitorët Naim Gjoshi dhe Xhevdet Gashi dekorohen me çmimin 'Mjeshtër i Merituar'

PRISHTINË, 1 PRILL (ER) - Kompozitorët e njohur Naim Gjoshi dhe Xhevdet Gashi janë

dekoruar nga presidenti Hashim Thaçi me çmimin 'Mjeshtër i Merituar' për kontributin e tyre të

çmuar në kultivimin e këngës shqipe. "Me punën e tyre ata e pasuruan jetën artistike dhe kultur-

ore të popullit tonë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



## Japonia prezanton emrin e epokës së re

TOKIO, 1 PRILL - Japonia ka thënë se emri i epokës së re do të jetë "Reiwa" dhe do të fillojë kur Perandori Akihito të largohet nga fronin në fund të muajit. Sekretari i Kabinetit, Yoshihide Suga ka thënë më 1 prill se emri i ri do të fillojë se përdoruri më 1 maj, kur djali i Akihitos, Naruhito të zëvendësojë babanë e tij. Ai ka thënë se ky emër

daton nga shekulli i shtatë dhe ka dy kuptime: "rei" që do të thotë "rregull" dhe "wa" zakonisht përshkruhet si "paqe" dhe "harmoni". Kryeministri japonez Shinzo Abe ka thënë gjatë një fjalimi para kombit se ky emër nënkupton se kultura ka lindur tekta njerëzit "kujdesen për njëri-tjetrin". Njoftimi i emrit të ri konsidero-

het moment shumë i rëndësishëm në Japoni dhe shënohet me festivale dhe ngjarje speciale. Akihito, 85-vjeçar ka njoftuar më 2017 se do të largohet nga fronin më 30 prill të vitit 2019, duke përmendur shkaqe shëndetësore. Emri i epokës së re ka ndikim shumë të madh në jetën e përditshme në Japoni, pasi njerëzit tani presin se çfarë do të

ndodhë pas zëvendësimit të epokës së Akihitos, e cila ishte emëruar "Heisei" dhe do të thotë "paqja triumfon gjithandej". Japonia ende përdor kalendarët perandorakë të stilit kinez, vendi i vetëm në botë që bën një gjë të tillë. Aktualisht në Japoni është viti, Heisei 31, apo viti i 31-të i mbretërisë së Akihitos dhe jo



2019. Një panel prej nëntë personave është përfshirë për muaj në bisedime sekrete për të zgjedhur këtë emër.

# Trumpi vazhdon kërcënimet për mbylljen e kufirit me Meksikën

Derisa po ndodh një rritje e vazhdueshme imigrantësh të paligjshëm, që kanë vënë në pozita të vështira burimet dhe personelin federal përgjatë kufirit amerikano-meksikan, presidenti Donald Trump kërcënoi ta mbyllë kufirin jugor të Amerikës me Meksikën

UASHINGTON, 1 PRILL - Uashingtoni është përqendruar përsëri tek imigracioni dhe siguria kufitare pasi presidenti Donald Trump kërcënoi ta mbyllë kufirin jugor të Amerikës me Meksikën dhe deklaroi se synon ndërprerjen e ndihmave të Shteteve të Bashkuara për tri vende të Amerikës Qendrore. Lëvizjet e presidentit Trump vijnë ndërsa po ndodh një rritje e vazhdueshme imigrantësh të paligjshëm, që kanë vënë në pozita të vështira burimet dhe personelin federal përgjatë kufirit amerikano-meksikan. Sipas Departamentit të Sigurisë Kombëtare, prurjet e imigrantëve përgjatë kufirit jugor të Amerikës janë rritur në 97 për qind krahasuar me një vit më parë, ndërsa ndalimet mesatare ditore arrijnë në 2 000 individë, kryesisht nga Amerika Qendrore.

Presidenti Trump ka premtuar veprim. "Tani kemi dy karvanë të mëdhenj që vijnë nga Guatemala, karvanë masivë që lëvizën lehtësisht përmes Meksikës. Meksika e ka forcën, por ata vendosën të mos i ndalojnë dhe në se ata nuk e bëjnë një gjë të tillë, ne do të mbylhim kufirin. Dhe do ta

mbajmë të mbyllur për një kohë të gjatë, unë nuk luaj lojëra", tha presidenti.

Një hap i tillë nuk është i paprecedent. Në vitin 1985, presidenti i atëhershëm, Ronald Reagan, mbylli përkohësisht pikat e shumta të hyrjes për të protestuar rrëmbimin e një agjenti amerikan kundër drogave në Meksikë. Mbyllja e kufirit për një periudhë të gjatë do të dëmtonte rëndë tregtinë mes dy vendeve, që arrin në më shumë se 500 miliardë dollarë në vit.

Ministri i Jashtëm i Meksikës, Marcelo Ebrard, reagoi ndaj presidentit Trump në Twitter, duke thënë se Meksika nuk u përgjigjet kërcënimeve dhe se do të merret me çështjet e migrimit me përgjegjësi dhe me respekt.

Ligjvënësit në Uashington po reagojnë. Senatori demokrat nga Nju Meksiko Tom Udall shkroi në Twitter se kufiri ShBA-Meksikë "është një mishërim i tregtisë, aktivitetit ekonomik dhe gjallërisë kulturore" dhe se mbyllja e pikave kufitare do të sillte 1.4 miliardë dollarë humbje në ditë.

Demokratët që konkurrojnë për të sfiduar Trumpin në garën presidenciale të vitit të



ardhshëm gjithashtu po reagojnë. "Ne jemi të sigurt, edhe pse jemi një qytet imigrantësh dhe azilkerkuesish. Jemi të sigurt pikërisht nga ky fakt. Ne kemi mësuar të mos i kemi frikë dallimet tona, por t'i respektojmë dhe t'i përqafojmë ato", tha kandidati presidencial Beto O'Rourke. Shtëpia e Bardhë thotë se presidenti Trump nuk ka zgjidhje

tjetër veçse të marrë masa drastike. "Demokratët nuk do të na japin ndonjë fond shtesë për ta bërë këtë, nuk do të na japin burime njerëzore shtesë dhe, më e rëndësishmja, nuk do të ndryshojnë ligjin që vepron si një magnet gjigant për njerëzit që vijnë nga Amerika Jugore dhe Qendrore. Përballë këtyre kufizimeve, presidenti do të bëjë gjithçka që mundet. Nëse

kjo arrihet me mbylljen e pikave kufitare, atëherë kjo është pikërisht ajo që presidenti do të bëjë", tha shefi i personelit të Shtëpisë së Bardhë në detyrë, Mick Mulvaney.

Presidenti Trump tha se dëshiron që ndihma amerikane për El Salvadorin, Guatemalën dhe Hondurasin të ndalet - diçka kjo që do të kërkonte veprimin e Kongresit.

## Zelenskiy kryeson në zgjedhjet presidenciale në Ukrainë

KIEV, 1 PRILL - Në zgjedhjet presidenciale të Ukrainës, komediani Volodimir Zelenskiy dhe presidenti i tanishëm Petro Poroshenko kryesojnë garën, pas numërimit të mbi gjysmës së fletëve të votimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tha se 41-vjeçi Zelenskiy, aktor komik që luan rolin e presidentit në një seri komike televizive, doli në vendin e parë me mbi 30.5 për qind të votave, ndërsa Poroshenko i dyti. "Njerëzit

janë para së gjithash për mua, ata janë më të rëndësishëm sesa aktiviteti dhe ambiciet politike. Ukrainasit po na prisnin", tha Zelenskiy.

Poroshenko, i cili ka qenë në pushtet që nga viti 2014, doli në vendin e dytë me rreth 17 për qind.

Ish-kryeministrja Yulia Tymoshenko ishte në vendin e tretë me 13 për qind të votave. Nëse rezultatet mbeten dhe asnjë kandidat nuk fiton shumicën, më 21 prill do të mbahet një balotazh mes dy kandi-

datëve kryesorë.

Volodimir Zelenskiy është i ri në politikë dhe është kritikuar se nuk ka dhënë shumë detaje mbi politikën e tij të ardhshme nëse zgjidhet.

Nga ana e tij, Poroshenko është akuzuar nga kundërshtarët se ka autorizuar skema për blerje votash. Miratimi i tij nga publiku pësoi rënie për shkak të vështirësive ekonomike në vend. Fushata e tij përfshinte premtimin për të rimarrë kontrollin e Krimesë pas aneksimit të saj nga Rusia në vitin 2014.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tha të hënën se asnjë shkelje sistematike nuk

u regjistrua gjatë zgjedhjeve me gjithë akuzat për blerje votash në shkallë të gjerë.

## Sophie Turner tregon si nisi lidhja e saj me Joe Jonas



**S**ophie Turner ka folur për romancën e saj moderne. Në një intervistë të fundit, aktorja 22-vjeçare zbuloi se i fejuari i saj Joe Jonas fillimisht i shkroi asaj nëpërmjet "Instagram"-it. "Kishim shumë miq të përbashkët. Dhe ata kishin qenë duke u përpjekur për të na

bërë miq që një kohë të gjatë. Ne ndoqëm njëri-tjetrin në 'Instagram' dhe ai më shkroi një ditë", ka treguar Sophie. Sophie dhe këngëtari 29-vjeçar fillimisht u takuan në nëntor të vitit 2016 para se Joe t'i propozonte asaj lidhje në tetor të vitit 2017.

## Gigi Hadidi thotë se nuk do të ribashkohet me Zayn Malik



**A**ta për kohën sa ishin bashkë kanë qenë një nga çiftet më të famshme të shoubizit, mirëpo modeluesja e famshme Gigi Hadid thotë se nuk do të kthehet sërish në lidhje me këngëtarin po ashtu të famshëm, Zayn Malik. Një

burim i afërt për 'Us Weekly' me bukurshet ka thënë se Gigi dhe Zayn ende flasim me njëri-tjetrin. Burimi ka shtuar se modeluesja ka ende ndjenja për këngëtarin, por mendon se lidhja e tyre nuk do të ecë.



## Kylie Jenneri pranon se e ndihmoi edhe familja për t'u bërë miliardere

**K**ylie Jenneri ka sqaruar titullin 'selfmade' miliardere. Pasi 'Forbe'-si e renditi 21-vjeçaren si miliarderja më e re në botë, Kylie ka pohuar se u ndihmua edhe nga familja e saj dhe lidhjet e tyre. Në një intervistë të dhënë kohën e fundit për 'Nju Jork

Times', Kylie ka pranuar se ajo nuk mund të thotë se është bërë vetë miliardere. "Nuk mund të them se e kam bërë vetë. Nëse ata flasin vetëm për financat, teknikisht po, nuk kam para të trashëguara. Por, kam pasur shumë ndihmë", ka thënë Kylie.

## Emily Ratajkowski duket e mrekullueshme edhe jashtë pasarelës



**M**odeluesja e 'Victoria Secret', Emily Ratajkowski, bashkë me bashkëshortin Sebastian Bear-McClard gjatë fundjavës që lamë pas ishin duke shikuar një ndeshje të

basketbollit. Ekipet që luajtën në këtë ndeshje ishin Miami Heat kundër Nju Jorkut. Modeluesja dukej shumë e bukur në këtë paraqitje. Ngjyra rozë i rrinte bukur.

**E jashtëzakonshme**

## Krijohet parfumi më i shtrenjtë në botë, 'Shamukh'

Një parfumeri në Emiratet e Bashkuara Arabe pretendon se ka krijuar parfumin më të shtrenjtë në botë. Ai quhet 'Shamukh', që në arabisht do të thotë "Ti meriton më sublimen", e çmimi llogaritet në 1.295.000 dollarë për tri litra. Prodhuesit thonë se parfumi është rezultat



i tre vjetëve kërkimesh dhe 494 eksperimentesh për arritjen e aromës më të mirë.

**FOTO E DITES**



Një kolazh nga artisti JR është zbuluar në oborrin e Luvrit për ta shënuar 30-vjetorin e piramidës së xhamit të muzeut në Paris. Fotografia: JR-ART.net /AFP/

**E rrallë**

## Divorcohet pas 13 vjetësh, gruaja feston në mënyrë të çuditshme

Marie Lollis donte ta festonte hapjen e një kapitulli të ri në jetën e saj. Kjo nuk kishte të bënte me fejesën, martesën, ardhjen në jetë të një fëmije, apo diçka tjetër. Mirëpo Marie ishte shkurorëzuar dhe kjo e bënte atë të jetë shumë të lumtur. Gruaja është bërë sensacion në internet për shkak se



pas shkurorëzimit ka shkatërruar albumin me fotografi, duke thënë se kjo është një gjë e lumtur.

**BARSOLETA E DITËS**



**Djali:**  
- Babi, a është e vërtetë se në disa vende burrat nuk i njohin gratë para martese?  
**Babai:**  
- Ajo ndodh në të gjithë planetin, bir. Pasi martohesh e merr vesh se kush është gruaja.




**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

### "HOW TO TRAIN YOUR DRAGON; The Hidden World" 3D

I Animuar/Aksion Aventure; 1 ore 44 min

Rolet: Jay Baruchel, America Ferrera, Cate Blanchett, Kit Harrington, Craig Ferguson, F. Murray Abraham, etj.  
Regjia: Dean DeBlois



**Në ora 20:00**

### "CAPTAIN MARVEL" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 ore 08 min

Rolet: Brie Larson, Samuel L. Jackson, Ben Mendelsohn, Djimon Hounsou, Lee Pace, Gemma Chan, Annette Bening, Jude Law, etj.  
Regjia: Anna Boden, Ryan Fleck



**Në ora 18:00 (gjate vikendit ne ora 14:00 dhe 18:00)**

### "THE KID WHO WOULD BE KING"

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 ore 50 min

Rolet: Louis Ashbourne Serkis, Dean Chaumoo, Tom Taylor, Rhianna Dorris, Angus Imrie, Rebecca Ferguson, Patrick Stewart, etj.  
Regjia: Joe Cornish




Regjia: Joe Cornish

**Në ora 22:00 "U S"**

Horror/Triller; 1 ore 56 min

Rolet: Lupita Nyong'o, Winston Duke, Elisabeth Moss, Tim Heidecker, Yahya Abdul-Mateen II, Anna Diop, Evan Alex, Shahadi Wright Joseph, Madison Curry, Cali Sheldon, Noelle Sheldon  
Regjia: Academy Award-winning visionary Jordan Peele



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Edhe pse në ambientin e punës mund të keni probleme të vogla, personat që ju rrethojnë nuk kanë qëllime negative karshi jush.</p>	 <p><b>DEMI</b> Sot do të rriteni shpirtërisht duke dëgjuar muzikë të mirë dhe duke ndenjtur në ambiente intelektuale që kishin kohë që ju mungonin.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Nëse keni marrë përsipër të përshkoni një rrugë të caktuar nuk duhet të keni më mëdyshje. Çdo kthim pas do t'ju kushtojë.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Shumë objektiva tuajat po i anashkaloni vetëm për një hutim të çastit. Do të jetë më mirë të kërkonti këshilla te personat e duhur.</p>	 <p><b>LUANI</b> Po ju jepen shumë mundësi në karrierë dhe jeni të dyzuar ndërmjet oportuniteteve që do të zgjidhni. Kërkoni mendimin e familjes.</p>	 <p><b>VIRGJËRESHA</b> Çdo gjë po shkon më së miri nga ana sentimentale. Ju ndiheni në qiellin e shtatë nga një dhuratë që ju ka bërë partneri.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Momenti më i mirë i ditës suaj është mëngjesi. Keni kohë të mendoni për çdo gjë dhe jeni më produktiv dhe energjik.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Duhet t'i shfrytëzoni informacionet e reja që do të merrni dhe nuk keni pse merrni kohë që të mendoheni. Çdo gjë ka për të shkuar siç e keni vendosur.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Sot po reflektoni mbi çështje që më parë ju janë dukur shumë të thjeshta. Keni anashkaluar gjëra të rëndësishme që tashmë janë bërë probleme.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> U bë disa kohë që një person i caktuar po ju bezdis lidhur me një temë që ju nuk dëshironi ta prekni. Sot do të tregoheni shumë i prerë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Sot do të keni surpriza pozitive dhe negative. Keni lënë për shumë kohë pezull një situatë që tashmë ka degjeneruar.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Nëse doni ta rrisni vetëbesimin e dikujt sot, është mirë ta merrni dhe të diskutoni me qetësi ngjarjet e fundit që i kanë ndodhur.</p>

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Rexha: Do ta ruajmë epërsinë ndaj Prishtinës dhe Llapit

Autori i 13 golave në këtë kampionat, Kastriot Rexha, nuk është i shqetësuar për barazimin e Feronikelit ndaj Flamurtarit. Ai thënë se rëndësi ka fakti që skuadra nga Drenasi ka tri pikë më shumë se Prishtina dhe pesë më shumë se Llapi. "Për ne ndeshja me Flamurtarin ishte shumë e rëndësishme dhe synim kishim fitore, por edhe një pikë nga kjo ndeshje nuk është keq për klubin tonë sepse mbesim ende në pozitën e parë me tri pikë dallim me Prishtinën që është kundërshtarë për titullin e kampionit", ka deklaruar Rexha



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 1 PRILL** - Skuadra e Feronikelit ka dështuar ta marrë maksimumin e pikëve në ndeshjen ndaj Flamurtarit (0-0), e cila është zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Sulmuesi i skuadrës nga Drenasi, Kastriot Rexha, ka thënë të hënën për "Epokën e re" se synim i liderëve të elitës në këtë përballje ishin tri pikët, por edhe barazimi nuk është rezultat i keq, për faktin se "Nikli" mban pozitën e parë të IPKO Superligës së Kosovës në Futboll. "Për ne ndeshja me Flamurtarin ishte shumë e rëndësishme dhe synim kishim fitore, por edhe një pikë nga kjo ndeshje nuk është keq për klubin tonë sepse mbesim ende në pozitën e parë me tri pikë dallim me

Prishtinën që është kundërshtarë për titullin e kampionit. Kemi një mundësi të mirë që ta ruajmë epërsinë ndaj dy konkurrenteve për titull dhe normalisht se do ta shfrytëzojmë", ka thënë Rexha. Sulmuesin më të mirë në këtë kampionat në futbollin e Kosovës nuk e shqetëson shumë barazimi ndaj Flamurtarit dhe mosshënimi i golave në këtë ndeshje, pasi beson se në ndeshjen e radhës ndaj Ballkanit në mesjavë, Feronikeli do t'u rikthehet fitoreve. "Ky rezultat nuk do të ndikojë aspak në ndeshjet e radhës, por do të na bëjë edhe më të mobilizuar për të mos lëshuar pikë të tjera. Ndeshjen e radhës e kemi ndaj Ballkanit në shtëpi dhe normalisht se presim fitore. Përndryshe, skuadra e Ballkanit është mjaft cilësore dhe ka futbollistë të dëshmuar. Ne e

respektojmë maksimalisht, por pikët mbesin në Drenas", ka shtuar Rexha. Feronikeli në 24 ndeshjet e zhvilluara deri tash ka arritur 17 fitore, 5 barazime dhe 2 humbje dhe ka grumbulluar 56 pikë, kurse Prishtina është në pozitën e dytë me tri pikë me pak, derisa në pozitën e tretë është Llapi me 51 pikë. Ndeshja në mes të Feronikelit dhe Ballkanit zhvillohet të enjten nga ora 14:00 në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas.

## IPKO SUPERLIGA

**Të mërkurën takohen:**  
**Trepça '89 - Flamurtari**  
**Llapi - Ferizaj**  
**Drenica - Gjilani**  
**Drita - KEK-u**  
**Të enjten takohen:**  
**Feronikeli - Ballkani**  
**Prishtina - Liria**

## SHKURT

### Sokoli: Kemi synime të mëdha ndaj Llapit

Skuadra e Ferizajt do të luajë në mesjavë në stadiumin "Zahir Pajaziti" ndaj Llapit. Trajneri Bylbyl Sokoli do të përballet për herë të parë ndaj ish-skuadrës nga Podujeva. "Favorit është Llapi. Ne do të përpiqemi të prezantohemi sa më mirë që është e mundur në Podujevë. Në çdo ndeshje përpiqemi ta japim maksimumin. Edhe në këtë ndeshje do të përpiqemi në maksimum, por mbetet të shihet se çfarë do të ndodhë", ka deklaruar Sokoli.

### Jep dorëheqje Nazmi Rama

Trajneri Nazmi Rama ka dhënë dorëheqje nga pozita e trajnerit të KF Dukagjini nga Klina. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e skuadrës që bënë gara në Ligën e Parë. "Pas ndeshjes së zhvilluar në Hogosht, trajneri Nazmi Rama është larguar nga klubi pas rezultateve të treguara në sezonin pranveror. Në mbledhjen e kryesisë është miratuar dorëheqja tije. Ne e falënderojmë dhe i urojmë suksese e shëndet gjatë jetës", thuhet në njoftimin e Dukagjinit.

### Bekim Jashari pret fitueset e Kupës në volejboll

Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, Ramiz Shala, kanë pritur në takim volejbollistët e Klubit të Volejbollit "Skenderaj". Skuadra nga Skenderaj në finalen e Kupës së Kosovës në volejboll fitoi me rezultat 3 m 1 në sete. "Jam ndier i lumtur me suksesin tuaj, për çka ju falënderoj në emër të të gjithë qytetarëve dhe ju siguroj se si komunë do t'ju mbështesim në aktivitetet sportive", ka thënë kryetari Jashari, duke u dëshiruar volejbollistëve të KV "Skenderaj" suksese të tjera në garat vendore dhe në ato ndërkombëtare.

### Agolli: Shqipëria ishte mësim për Panuccin

Mbrojtësi Ansi Agolli e ka komentuar shkarkimin e trajnerit Christian Panucci. Sipas ish-kapitenit kuqezë, Shqipëria ishte një përvojë e mirë për trajnerin italian. "Çdo trajner kur merr një detyrë mendon si të paraqitet sa më mirë dhe të arrijë rezultate me skuadrën, por ndonjëherë duhen shumë faktorë për të bërë sukses. Duka i ka dhënë besim trajnerit, por rezultatet nuk ishin në favor të tij dhe puna e një trajneri matet pikërisht me rezultate. Mendoj se kjo përvojë do t'i japë ca mësim të mira edhe Panuccit, gjithmonë nëse do të vijojë të punojë si trajner", ka thënë Agolli.

### FBK-ja organizon aktivitet për fëmijët me autizëm

Nën organizim të organizatës "Autizmi Flet" dhe në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK), si dhe mbështetur nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Prishtinës dhe Qendra Social-Edukative "Don Bosko" në Prishtinë, do të organizohet një aktivitet i përbashkët kushtuar fëmijëve me autizëm. Aktiviteti do të mbahet më 27 prill në orën 12:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Në ditët në vazhdim Federata e Basketbollit të Kosovës dhe organizata "Autizmi Flet" do të organizojnë një konferencë të përbashkët për media për të dhënë detaje të tjera rreth aktivitetit në fjalë. FBK-ja ndihet e nderuar që për herë të parë do të jetë bashkorganizatore e një aktiviteti për fëmijët me autizëm duke i përkrahur ata nëpërmjet një aktiviteti të basketbollit.

## Vëllaznimi rikthen Blerim Mulën

**GJAKOVË, 1 PRILL** - Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova e ka rikthyer ish-lojtarin e shquar Blerim Mula. Skuadra kuqezë ia ka besuar Mulës detyrën e drejtorit të akademisë së klubit. "Është arritur marrëveshja

zyrtare ndërmjet klubit të Vëllaznimit dhe ish-lojtarit të shquar shumëvjeçar të këtij klubi dhe të klubeve të elitës së futbollit të Turqisë, Blerim Mula, për rikthimin e tij në radhët e klubit tonë. Blerim Mula,

trajner i dëshmuar ndër vite, prej sot është emëruar drejtor i akademisë së futbollit të klubit të Vëllaznimit", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit. Skuadra gjakovare po ashtu ka njoftuar të gjithë të interesuarit

se duke filluar nga data 15 prill fillon regjistrimi i të interesuarve për të qenë pjesë e akademisë së Vëllaznimit. Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë fëmijët nga moshë 7 e deri në moshën 17 vjeç.



## Klitschko në maj i rikthehet boksit

KIEV, 1 PRILL - Boksieri ukrainas Wladimir Klitschko do të rikthehet në ring më 25 maj. Legjenda e peshës së rëndë ka arritur një marrëveshje me televizionin DAZN, nga e cila do të përfitojë 120 milionë dollarë për një seri duelesh. Duelin e parë ukrainasi do ta zhvillojë në vendlindjen e tij, në stadiumin

"Olimpik" në Kiev. "Kundërshtari? Do të jetë i jashtëzakonshëm. Do të jetë një nga sfidat më tërheqëse që keni parë kohët e fundit", mësohet se ka thënë Klitschko.

Ukrainasi është tërhequr nga sporti në korrik të vitit 2017, pas dy humbesh radhazi nga dy boksierë britanikë, Tyson

Fury dhe Anthony Joshua. Fillimisht u përfol se 43-vjeçari do të rikthehej në ring për revanshin ndaj Joshuas, por u tërhoq. Ende nuk dihet se cili është rivali i 25 majit dhe se për sa duele është kjo marrëveshje mes Klitschkos dhe DAZN. Gjithsesi, përfillet për katër duele që do të zhvillohen deri në fund të vitit 2020.



## Gjilani - Drita zhvillohet në Prishtinë, kundërshtojnë 'Plisat'

PRISHTINË, 1 PRILL - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Gjilanit dhe Dritës do të zhvillohet më 7 prill në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Skuadra e Gjilanit ka njoftuar se ky vendim ka ardhur pasi stadiumi "Agim Ramadani-Katana" është duke u rinovuar dhe nuk ofron siguri të mjaftueshme. "Ndeshja kundër rivalit lokal KF Drita është zhvendosur në kryeqytet dhe do të luhet në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë, pasi stadiumi 'Agim Ramadani-Katana' gjendet në renovim dhe nuk i plotëson kushtet dhe sigurinë për mbarëvajtjen e këtij dueli", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

Mirëpo vendimi i zhvillimit të ndeshjes në kryeqytet nuk u ka pëlqyer aspak "Plisave", të cilët kanë reaguar nëpërmjet një postimi në "Facebook". "Kryetari Agim Ademi paska marrë vendim që ndeshja Drita - Gjilani të luhet në stadiumin e Prishtinës. Stadiumi i Prishtinës, sipas Agim Ademit, mund të shndërrohet në




pronë e cila lëshohet për këdo që dëshiron të luajë në fushë të mirë. Nuk është faji i Prishtinës që qytetet e tjera i kanë stadiumet sikur ara patatesh. Stadiumi i Prishtinës është vetëm për ndeshjet e Prishtinës dhe Kosovës dhe asnjë ekip tjetër nuk duhet të lejohet që të vijë këtu sepse pasojat po i bartim gjithmonë vetëm ne", thuhet në reagimin e "Plisave". "I bëjmë apel kryetarit të Komunes së Prishtinës, Shpend

Ahmetit, që komuna, së bashku me Klubin e Futbollit Prishtina, ta marrin në menaxhim stadiumin e Prishtinës e të mos mбетet në mëshirë të dallaveve e manipulimeve të FFK-së", thuhet në reagimin e "Plisave". Ndërsa tifozët e Dritës, "Intelektualët", kanë vendosur që të mblidhen të martën në stadiumin e tyre për të diskutuar rreth detajeve për udhëtimin në Prishtinë.

## Warriors i pandalshëm, Lakersat fitojnë pa Jamesin

LOS ANGELES, 1 PRILL - Stephen Curry dhe Klay Thompson udhëhoqën Golden State Warriorsin në fitoren e thellë ndaj Charlotte Hornetsit. Curry realizoi 25 pikë, ndërsa Thompsoni 24. Me këtë fitore skuadra nga Kalifornia mban kryesimin e konferencës së lindjes. Denver Nuggetsit u mund në shtëpi nga Washington Wizardsit me rezultatin 90-95. Nga skuadra Mike, Troy Brown Jr (24), Thomas Bryant (20) dhe Jabari Parker (20) ishin protagonistët në këtë triumf të Wizardsit. Danilo Gallinari shkëlqeu ndaj Memphis Grizzliesit me 27 pikë dhe 15 rebounde. Me këtë fitore, Clippersit shkon në vendin e pestë të tabelës së lindjes. Pavarësisht prej mungesës së



Lebron Jamesit, Los Angeles Lakers ia ka dalë të fitojë bindshëm ndaj New Orleans Pelicansit. Rajon Rondo, i cili

vinte si një "ish" në këtë përballje, regjistroi 24 pikë dhe 12 asistime, performancë e shkëlqyer edhe nga Alex Caruso, i cili e mbylli me 23 pikë, edhe pse u aktivizua nga stoli.

### SHKURT

#### Ronaldo mungon ndaj Ajaxit

Trajneri i Juventusit, Massimiliano Allegri, e ka pranuar se Cristiano Ronaldo do ta ketë shumë të vështirë të riaftësohet në kohë për ndeshjen e parë kundër Ajaxit në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Ronaldo është duke u shëruar nga një lëndim që e pësoi javën e kaluar në një ndeshje kualifikuese për Kampionat Evropian mes Portugalisë dhe Serbisë. "Cristiano po punon mirë, por vështirë se do të jetë i gatshëm për ndeshjen tonë kundër Ajaxit. I kemi nëntë ditë për ta vlerësuar gjendjen e tij", ka thënë Allegri.

#### Lenjani dhe Kasami, në formacionin e javës në Zvicër

Paraqitje të mirë në Superligën e Zvicrës patën edhe futbollistët shqiptarë. Sioni e ka mposhtur Zurichun me rezultat minimal 1-0, në një ndeshje ku shkëlqyen dyshja e shqiptarëve Ermir Lenjani dhe Pajtim Kasami. Dy futbollistët shqiptarë kanë zënë vend në formacionin më të mirë të javës nga 'sportalhd.com'. Pas kësaj fitore, Sioni është larguar nga zona e rrezikshme dhe zë pozitën e tetë në tabelë me 29 pikë të tubuara.

#### Unitedi kërkon dy futbollistë për Pogban

Reali i Madridit tashmë, përveç Mbappesë dhe Hazardit, kërkon të blejë dhe Paul Pogbanë. Ky lajm ka shkuar në veshët e Manchester Unitedit, skuadër e cila është gati ta japë mesfushorin francez për dyshen Bale-Kroos. Sipas "Mirror", klubi anglez mund ta lëshojë Pogbanë vetëm nëse Reali do të ulet të flasë për këtë shkëmbim të bujshëm. Bale dhe Kroos duan të largohen nga Reali dhe Unitedi është gati të rrimbejë këtë rast dhe ta japë Pogbanë.

#### Mourinho, afër PSG-së

Jose Mourinho ka nisur bisedimet me kampionët e Francës, Paris Saint-Germain. Sipas medieve franceze, Mourinho do ta marrë drejtimin e skuadrës sezonin e ardhshëm. Edhe pse Tomas Tuchel është një preferencë personale e presidentit Naser Al-Khelaifi, dështimi në Ligën e Kampionëve mund t'i humbasë vendin në krye të bankinës. Mourinho nuk ka drejtuar asnjëherë në Francë, por nuk e ka mohuar që e tërheq ideja e drejtimin në Ligën 1. Sipas medieve franceze, "Special One" është në bisedime me klubin prej disa muajsh tashmë. Mbetet ende për t'u parë nëse do të arrihet një pajtim. Mourinho është pa ekip qëkur u shkarkua nga kreu i Manchester Unitedit, në muajin dhjetor. Portugezi kërkon një rrogë 20 milionë euro në sezon, por për PSG-në, paratë nuk janë një problem.

#### Hamiltoni: Leclerc meritonte fitoren në Bahrein

Pas suksesit në Çmimin e Madh të Australisë, Mercedesi triumfoi edhe në Bahrein, por këtë radhë sukcesi ishte më shumë me fat sesa për meritën e tyre. Charles Leclerc u tradhtua nga motori i Ferrarit të tij, ndërsa Vetteli gaboi gjatë një dueli me britanikun për vendin e dytë në garë. Vetë kampioni i botës pranoi se piloti 21-vjeçar i Ferrarit e meritonte më shumë fitoren e garës sesa ai. "Leclerc meritoi ta fitonte garën, ishte fantastik. Gara ishte e vështirë, por ne nuk gabuam dhe shfrytëzuam rastet që na u dhanë. Dueli me Vettelin ishte shumë i bukur dhe argëtues. Frynte shumë erë në kthesën 4 dhe ndonjëherë e merrja atë gjerë. Ishim me fat dhe shfrytëzuam situatat", ka thënë Hamiltoni. Edhe më i drejtpërdrejtë ishte Toto Wolff, i cili pranoi se skuadra e tij pati fat. "Kishim shumë fat. Zoti i garave pa nga ne sot. Strategjia funksionoi mirë, Hamiltoni ushtroi presion mbi Vettelin, por e vërteta është se Leclerc ishte më i shpejtë. Por, garat janë të tilla. U treguam kursimtarë me gomat dhe, përpara se të shfaqej problemi, ne ishim shumë larg Leclerc", ka deklaruar Wolff.

### REZULTATET

Golden State W. - Charlotte Hornets	137-90
Denver N. - Washington W.	90-95
Los Angeles Clippers - Memphis G.	113-96
New Orleans Pelicans - LA Lakers	102-130
San Antonio S. - Sacramento K.	106-113





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në  
**Shitjen 45**

të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:


Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: **e mërkurë 03 prill 2019**, prej orës **10:00 - 12:00**,  
në **“Sallën e konferencave - Hotel Grand”**, Prishtinë.

**\* Shënim:** Njësia në vijim është tërhequr nga Shitja e aseteve 45:  
**NJËSIA 61: Ratar Tokë Bujqësore Hajvali IV**

### Si duhet të përgatitet oferta:

**OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).**

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një pliko (zarf) të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**  
Brenda këtij zarfi (**ZARFI 3**), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: **ZARFI 1** dhe **ZARFI 2**



Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit

**“Informata shtesë për ofertën”**

1. Dokumentet e cekura në pikën 8.6. ii të Rregullave të Tenderit.
2. Originalin e formularit për dorëzimin e ofertës - **“SHTOJA C”**, e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesi.
3. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.
4. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së.

**SHTOJA "B" - PASQYRA E ÇMIMIT TË OFERTËS**

Emri i Plotë i Ofertuesit: Filip Fostaka

Numri i njësisë dhe emri i aseti/subjekti të ri: Njësia nr. XX (emri i njësies)

SHAL numër: 242-15

**ÇMIMI I OFERTËS – SHËNO ÇMIMIN E OFERTËS QË JU SYNONI TË PAGUANI PËR SUBJEKTIN RI NË SHIFRA**

Qindra Miliona	Dyqinda Miliona	Miliona	Qindra Miliona	Dyqinda Miliona	Miliona	Qindra Miliona	Dyqinda Miliona	Miliona

NË FIALË Njëqindëjtë euro

**SHËNIME:**

- NË RAST TË ÇFARËDO MOSPËRPUTHJE NË TABELË, NË MËS TË SHUMËS SË PARAQITUR ME SHKRONIA DHE SHUMËS SË PARAQITUR ME SHIFRA DO TË MBIZOTËROJ SHUMA E PARAQITUR NË SHKRONIA DHE DO TË TRAITOHET SI ÇMIMI I OFERTËS.
- NË RAST SE SHUMA E PARAQITUR ME SHIFRA DHE SHUMA E PARAQITUR ME FIALË JANË TË PALEXUESHME DHE/OSE TË PAKUPTUESHME, OFERTA E OFERTUESIT DO TË DISKUALIFIKOHET.
- NUK LEJOHET ASNË NDËRSHIM/PËRMBIRËSIM I ÇMIMIT TË OFERTËS.
- AGENCIJA DO TË SHTUARË TË PRALEXUESHME OFERTËN E DORËZUARË E CILA KA NDËRSHIM/PËRMBIRËSIM TË ÇMIMIT TË OFERTËS SIPAS NENIT 13.1 TË KESAJ RREGULLOREJE.
- NË RAST SE OFERTUESI NUK PARAQET ÇMIMIN E OFERTËS, EDHE ME FIALË EDHE ME SHIFRA, OFERTA E TIU DO TË DISKUALIFIKOHET.

Emri & Mbledhja: Filip Fostaka Data: XXXXXX

Nënshkrimi: Fostaka

Ky nënshkrim po ashtu konfirmon se ofertuesi pranon shënimet më lartë dhe pajtohet që të obligohet me deklaratën e bërë këtu.  
Vlerëjje: Ju lutem kini parasysh se të gjitha fushat duhet të jenë të plotësuara. Në rast se ndonjë nga informatat mbeset e paplotësuar, oferta do të diskualifikohet.

**TË PLOTËSOHEN TË GJITHA FUSHAT!!**  
**KUIDES,**

\* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 45 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**  
**Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.**

#### LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173  
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontaktoni - Njësinë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë  
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevc Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë  
tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2004, 1090,1105, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076  
e-mail: shitja@pak-ks.org ose sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inistranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs  
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Odeljenje za Finansije i Opšte Usluge/Department of Finance and General Services  
Divizioni për Burime Njerëzore/ Divizija za Ljudske Resurse/Division of Human Resources

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Punëve të Jashtme, shpall:

## KONKURS

### Një (1) Zyrtar/e i/e Lartë për Traktate

**Departamenti/Zyra:** Divizioni për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare/ Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktate  
**Nr. i referencës:** MPJ-DTMN-001/03  
**Koeficienti:** 8

### Detyrat Kryesore:

- Mbikëqyrë zbatimin e traktateve dhe konventave ndërkombëtare në Kosovë;
- Bashkërendon procesin e negociimit dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat hyjnë në mandatin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe bashkërendon procesin e hyrjes në fuqi të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare;
- Interpreton marrëveshjet ndërkombëtare dhe ofron këshilla lidhur me zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ne sistemin ligjor të Kosovës;
- Interpreton memorandumet e bashkëpunimit dhe ofron këshilla lidhur me zbatimin e tyre ne sistemin ligjor të brendshëm të Institucioneve të Kosovës;
- Bën raportime për institucionet e tjera përkatëse për të dhënat mbi zbatimin e traktateve dhe konventave ndërkombëtare në Kosovë;
- Bën koordinimin e bashkëpunimit me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare në fushën e traktateve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare;
- Bashkërendon dhe ndërlihd punët sipas nevojës me zyrtarët e tjerë të Departamentit për çështje ligjore dhe traktate;
- Kryen të gjitha punët tjera të cilat i përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, lidhur me detyrat e vendit të punës.

### Shkathtësitë e kërkuara

- Trajnime profesionale;
- Aftësi të mira analitike;
- Aftësia për të punuar nën presion;
- Litësi pune dhe nivel të lartë integriteti;
- Njohja e gjuhës angleze e obliguar, përparësi edhe gjuhët tjera

### Kualifikimet dhe përvoja e punës:

- Diplomë universitare në fakultetin juridik, master i preferueshëm;
- Të paktën tri (3) vite përvojë pune profesionale;

### Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Kohëzgjatja e emërimit është pa afat - të përhershme (e karrierës) si dhe kohëzgjatja e periudhës provuese është 12 muaj, për pozitat e shpallura me këtë konkurs;

Formularët zyrtar për aplikim merren në Zyrën për Burime Njerëzore të MPJ-së, zyra nr. 103 .ish- ndërtesa e Eulexit (rruga Luan Haradinaj, 32) gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga Ueb-Faqja e internetit të MPJ-së.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmiave për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj. mund të dorëzohen:

- Drejtpërdrejtë në Zyrën për Burime Njerëzore të MPJ-së, dhe
- Përmes postës.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione me të dhëna të sakta. Në rast të mosplotësimit të këtyre kërkesave, ose ofrimit të informatave jo të sakta, aplikacioni refuzohet, gjithashtu përdorimi i formularëve jozyrtar rezultojnë në refuzimin e menjëhershëm të aplikimit.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të pranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar (postuar) para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit bëhet në përputhje me LSHCK, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.  
Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 02.04.2019, deri më: 16.04.2019, në ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MPJ-së, në telefonin: 038 200 77-073 dhe 038 200 77-118.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Ministrisë: [www.mfa-ks.net](http://www.mfa-ks.net)

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inistranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs  
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme/Odeljenje za Finansije i Opšte Usluge/Department of Finance and General Services  
Divizioni për Burime Njerëzore/ Divizija za Ljudske Resurse/Division of Human Resources

Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo i Uredbe br. 02/2010 član 15., stav 2. o proceduri regrutiranja u civilnoj službi, Ministarstvo inostranih poslova, objavljuje:

## KONKURS

### Jedan/na (1) Viši/a službenik/ca za ugovore

**Odeljenje/Kancelarija:** Divizija za međunarodne ugovore i sporazume/Odeljenje za pravna pitanja i ugovore  
**Br. reference:** MPJ-DTMN (MIP-DMUS) -001/03  
**Koeficijent:** 8

### Glavne dužnosti:

- Nadgleda sprovođenje ugovora i međunarodnih konvencija na Kosovu;
- Koordinira proces pregovaranja i potpisivanja međunarodnih sporazuma, koji spadaju u mandat Ministarstva inostranih poslova, kao i koordinira proces stupanja na snagu svih međunarodnih sporazuma;
- Tumači međunarodne sporazume i pruža savete o sprovođenju međunarodnih sporazuma u zakonskom sistemu Kosova;
- Tumači memorandumne o saradnji i pruža savete o njihovom sprovođenju u unutrašnjem zakonskom sistemu institucija Kosova;
- Vrši izveštavanja o drugim relevantnih institucija za podatke o sprovođenju ugovora i međunarodnih konvencija na Kosovu;
- Vrši koordinaciju saradnje sa relevantnim lokalnim i međunarodnim institucijama u oblasti ugovora i međunarodnih sporazuma;
- Koordinira i povezuje poslove prema potrebi sa drugim službenicima Odeljenja za pravna pitanja i ugovore;
